REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
01 Nr. / Br 141/23
Nr. i fq. / Br. st -17
Data: / Datum 19.06.2023
VUSHTRRI - VUČITRN

**REPUBLIKA E KOSOVËS** **KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI**

---

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28.1 të Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 6.3 të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës dhe Organeve të Tij, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

**Ju fton**

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **29 qershor 2023 (e enjte) me fillim në ora 10:00.** Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës në Vushtrri.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

**R E N D D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 31 maj 2023;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Kornizës Afatmesme (KAB) për vitet 2024-2026 dhe kalendarit kohor për mbajtje të takimeve me qytetarë;
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft – Planit Komunal për Integritet 2023 – 2025;
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft – Planit komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Vushtrrisë 2023 – 2025;
5. Shqyrtimi i Peticionit lidhur me rrugën "Wesly Clark";
6. Shqyrtimi i Peticionit lidhur me ndryshimin e pikës 2 të vendimit nr. 82/23, të datës 30.03.2023;
7. Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë lidhur me caktimin Lokacionit për ndërtimin e objektit të Kryqit të Kuq;
8. Shqyrtimi i kërkesës për financimin e botimit të librit "Rrezet e Lirisë – Dëshmorët e Kombit të Zonës së veprimit të Brigadës 142 të ZO të Shalës;
9. Shqyrtimi i kërkesës së Shoqatës së Burgosurve Politikë;
10. Shqyrtimi i Informatës për punën e Drejtorisë për Administratë, për periudhën janar – maj 2023;
11. Shqyrtimi i Raporti lidhur me gjendje momentale në Komunë Vushtrrisë pas vërshimeve dhe mundësia për përkrahje financiare për të dëmtuarit;
12. Të ndryshme.

**Melihate Basholli-Latifi**

**Kryesuese e Kuvendit të Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS · KOMUNA E VUSHTRRISË · OPŠTINA VUČITRN · REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
01 Nr. / Br 140/23
Nr. i fq. / Br. st -2-
Data: / Datum 19.06.2023
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUČITRN

| | |
|---|---|
| **PËR:** | **Kuvendin e komunës** |
| **NGA:** | **Melihate Basholli Latifi** ________<br>**Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë** |
| **TEMA:** | **Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga mbledhja e datës 16.6.2023** |

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 37, paragrafit 4 të Statutit të Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më **16 qershor 2023** ka shqyrtuar këto materiale dhe nxori këto rekomandime:

1. Shqyrtimi i Draft Kornizës Afatmesme (KAB) për vitet 2024-2026 dhe kalendarit kohor për mbajtje të takimeve me qytetarë.
   ***Për këtë pikë të rendit të ditës , KPF-ja rekomandoi që emrat e anëtarëve të KPF-së të mbesin në lokacionet e njëjta që kanë qenë vitin e kaluar, kurse datat e takimeve publike me qytetarë të hartohen nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

2. Shqyrtimi i Draft – Planit Komunal për Integritet 2023 – 2025.
   ***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:***
   ***Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

3. Shqyrtimi i Draft – Planit komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Vushtrrisë 2023 – 2025.
   ***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:***
   ***Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

4. Shqyrtimi i Peticionit lidhur me rrugën "Wesly Clark".
5. ***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:***
   ***Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

6. Shqyrtimi i Peticionit lidhur me ndryshimin e pikës 2 të vendimit nr. 82/23, të datës 30.03.2023.
   ***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:***
   ***Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

7. Shqyrtimi i kërkesës për financimin e botimit të librit "Rrezet e Lirisë – Dëshmorët e Kombit të Zonës së veprimit të Brigadës 142 të ZO të Shalës.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:*
*Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

8. Shqyrtimi i kërkesës së Shoqatës së Burgosurve Politikë.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:*
*Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

9. Shqyrtimi i Informatës për punën e Drejtorisë për Administratë, për periudhën janar – qershor 2023.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:*
*Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

10. Shqyrtimi i Raportit lidhur me gjendjen momentale nga vërshimet në Komunën e Vushtrrisë dhe mundësia e përkrahjes financiare.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:*
*Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

*Me respekt!*

**REPUBLIKA E KOSOVËS** **KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI**

# P R O C E S V E R B A L
## NGA MBLEDHJA E -V- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 31 MAJ 2023

*Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën* ***10:15.***
Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:
Adnan Lahu, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Faton Hyseni, Galip Audiu, Gresa Muli, Gentiana Rama, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Leonora Gërguri, Lorik Maxhuni, Mek Selaci, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Nasuf Aliu, Nurie Halili, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Refik Maloku, Shkelzen Xhaferi, Spasoje Stefanoviq, Sylejman Meholli, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, – kryesuese e kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezent 35 anëtarë të kuvendit, kuorum i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z. Ferit Idrizi, nënkryetari i komunës z. Shpëtim Zhegrova, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

**Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit-**paraqiti para kuvendit pika e dërguara në të ndryshme për ti inkorporuar në rendin e ditës.
**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit** –ngriti shqetësimin e tij lidhur me vendimin e kuvendit për caktimin e kahjeve për disa rrugë në qytetin e Vushtrrisë, e pas këtij vendimi disa nga kahet e këtyre rrugëve kanë ndryshuar, dhe nuk janë në përputhje me vendimin që e ka aprovuar kuvendi. Por lidhur me këtë çështje kemi edhe ankesa dhe një peticion të qytetarëve që kanë theksuar se caktimi i kaheve të këtyre rrugëve i ka dëmtuar bizneset e tyre. Andaj ai kërkoj sqarime se përse nuk po zbatohet vendimi i kuvendit dhe duhet konstatuar se ky vendim ai cenon interesat e bizneseve.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-** tha se të gjitha vendimet që i kemi marr bashkërisht në kuvend, ka pasur për intencë, lehtësimin dhe mbrojtën e interesave qytetare. Lidhur me vendimin për kahet e rrugëve, njoftoi se është ndryshua sa i përket rrugës tek spitale, pasi ka pasur pengesa në qarkullim. Në këtë kontekst janë duke u bërë disa analiza dhe vendimi do të sillet para kuvend për ndryshimet e duhura. Pastaj lidhur me peticionin për rrugën "Galip Badivuku" sqaroi se ajo rrugë ka qenë rrugë njëkahore, dhe nuk e di sa çfarë inpakti ka mundur të ketë. Më tej vlerësoi se me

Drejtorinë e Shërbimeve Publike do të analizojnë edhe rrugë tjera dhe konfom gjendje do të merren vendime adekuat për qarkullimin sa ma të lirshëm të komunikacioni në qytet. Në fund ceku se nëse konstatohet se vendimi për këto rrugë ka dëmtuar bizneset në Komunën e Vushtrrisë, atëherë ky vendim do të ndryshohet në kuvend.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit –**pyeti se a është duke u zbatuar vendimi i kuvendit për subvencionimin e nënave respektivisht për fëmijët e porsalindur në vlerë prej 120 €, sepse ka shumë ankesa që këto subvencione nuk i kanë marrë nënat që kanë lindur fëmijë gjatë kësaj periudhe të këtij viti.
**Nexhmedin Rashica, drejtor i DSHPS-së-**sqaroi se fëmijët e porsalindur janë subvencionuar në këtë vit në vlerë prej 9900 € në total, por ka problem për sa i përket fakti se vlera e subvencioneve është e limituar në krahasim me nevojat që kemi, prandaj do të mundohen të gjendet një formë për përmbushjen e obligimeve që dalin nga vendimi i kuvendit.
**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-** sqaroi se bazuar në instruksionet e Ministrisë së Financave, jemi të obliguar të bëjmë ndryshimin e vendimit të kuvendit sa i përket vlerës financiare prej 10,000 € e cila baret nga kategori paga dhe mëditje në kategorinë e subvencioneve. Andaj ndryshimi i këtij pozicioni intrferon në ndryshimin e dy vendimet me numër të protokollit 79/23 dhe 80/23 të datës 30.03.2023.
**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit –**tha se nuk ka pasur qasje nga njerëzit profesionit në hartimin e këtyre politikeve dhe vendimeve për bartjen e të hyrave vetanake, sepse ata nuk janë lejuar të punojnë, ndërsa për këtë LDK nuk e kishte përkrahur këtë politikë. Ai vlerësoi se kritika që i ka adresuar LDK në kuvend kanë qenë konstruktive, ndërsa ato është dashur të merren si të mirëseardhura e jo të përdoret arroganca e numrave.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**në emër të grupit kuvendar të LVV-së , propozoi që Avni Imerit, t'i jepet çmimi "Emblema e Komunës" post-mortum për veprimtarinë e tij patriotike si njëri ndër themeluesit e Zonës Operative të Shalë të UÇK-së.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**deklaroi se nuk është asnjëherë rezistentë ndaj kritikave dhe është hapur për mendimin ndryshe. Për ndryshimin e vendimeve për bartjen e të hyrave ceku se është kërkesë e ministrisë së linjës për ndryshimet e kërkuara.

**Në fund të debatit jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, Kuvendi pas votimit me vota "unanime" aprovoi këtë:**

**R E N D   D I T E**

**1.** Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 27 prill 2023;
**2.** Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim- vendimit për ndarjen e dekoratave dhe mirënjohjeve për "Ditën e Çlirimit";
**3.** Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me numër të protokollit nr.79/23 i datës 30.03.2023 për Bartjen e të Hyrave vetanake të tejkaluara nga viti 2022 në vitin 2023;
**4.** Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me numër të protokollit nr.80/23 i datës 30.03.2023 për Bartjen e të Hyrave Vetanake nga viti 2022 në vitin 2023;
**5.** Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft – Rregullores për Punën e Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë;

6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2022;
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për kompensimin të anëtarëve të Komisionit për verifikimin e procesit të dhënies në shfrytëzimin të pronës komunale;
8. Të ndryshme.

**1.** Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 27 prill 2023;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me vota "unanime", aprovoi procesverbalin nga mbledhja rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 27 prill 2023.**

**2.** Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim- vendimit për ndarjen e dekoratave dhe mirënjohjeve për "Ditën e Çlirimit";

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-**deklaroi se nuk mund të kalohet në votimin e pikave dy dhe tre pa u votuar pika e parë që janë propozimet për mirënjohje. Ndërsa shtoj se kur janë bërë këto propozime për çmimet e rëndësishme a ka pasur konsultim paraprak sepse vërtet është duke u vepruar në humbjen e vlerës së këtyre çmimeve të nderit, duke ndarë për dy apo tre persona çmimi i njëjtë. Pastaj shtoj se është dashur të ketë konsideratë për ndarjen e këtyre çmimeve duke e ruajtur vlerën dhe jo të propozohet sipas stilit kush të mundet më parë, sepse vërtet kështu janë duke u degraduar vlerat e njëmenda të titujve dhe personaliteteve të respektuara të komunës sonë dhe më gjerë. Në fund ai propozoi z.Habib Mustafa për mirënjohje, por nëse gjendet se ka marr më herët mirënjohje ai e tërheqë propozimin.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**tha se ndarja e këtyre titujve dhe dekoratave nuk e zbeh vlerën por vetëm sa e pasuron historinë dhe kujtesën tonë kolektive për figurat dhe personalitet tona të njohura që kanë kontribuar për lirinë dhe çështjen kombëtare në periudha të ndryshme. Andaj propozimet e tilla që janë proceduar, duhet aprovuar, sepse aprovimi i tyre do ti bëj nder këtij kuvend dhe komunës në përgjithësi, kërkoj nga kuvendi që në mënyrë unanime të aprovoj këto propozime për këto dekorata. Në vazhdim ai në mënyrë të veçantë arsyetoj të gjitha propozimet për titujt dhe çmimet që janë propozuar për personalitete të ndryshme dhe kërkoj që ato të aprovohen me votë nga secila parti politike e përfaqësuar në kuvendin e komunës pa pasur asnjë ndarje politike apo partiake.
**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit –**paraqiti vërejtjet e tij sa i përket listës për ndarjen e mirënjohjeve, e paraqitur nga organizatat e luftës së UÇK-së , ku vlerësoi se secilit ushtarë të UÇK-së ai i përkulët për sakrificën që ka bërë në luftë, por nuk pajtohet që njërit nga të propozuarit z.Gëzim Saraçi ti ndahet mirënjohje sepse i njëjti pas luftës ka ushtruar pozitën e Drejtorit të Inspektimeve dhe qytetarët kanë pasur shumë vërejtje për punën e tij, kjo nuk është në rregull dhe nëse ky njeri mbetet në listë vota e tij do të jetë kundër.
**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit –**tha se vërtet është duke u degraduar vlera e mirënjohjeve, duke shpallur nga dy apo tre propozime për një çmim, dhe shtoj se si LDK nuk janë kundër askujt por kërkojë që herëve tjera të shmanget kjo praktik e keq dhe të zbatohet rregullorja për dekorata që është aprovuar nga kuvendi.
**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit –**në listën për mirënjohje post-mortum propozoi Dalip Malokun, i cili ka qenë pjesëtarë i UÇK-së, me komandantin Gani Imeri. Dalipi pas luftës kishte

shkuar në Turqi për të studiuar për teologji por fatkeqësisht ai humbi jetën tragjikisht në basenin e Gërmisë. Sot rruga kryesore në fshatin Stanoc i Epërm mbanë me krenari emrin e tij. Pastaj propozoi që listës për mirënjohje t'i shtohet edhe emri i z.Rasim Vatovcit, i cili është një fermerë i vyer i Komunës së Vushtrrisë dhe ai meriton të nderohet me mirënjohje për punë e tij të madhe që bënë në lëmin e bujqësisë në rritjen e krerëve të lopëve.
**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit** –vlerësoi se është mirë që është ngritur një komision për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Dekorata, sepse kjo rregullore është e mangës, ku vetëm në dy raste janë cekur numri i çmimeve dhe mirënjohjeve që mund të ndahen, ndërsa nuk është përcaktuar as forma e votimit.
**Mek Selaci, anëtar i kuvendit** –propozoi që t'i ndahet mirënjohje z. Bashkim Musa, i cili punon në Xhami në qytet si mejzinë, por i cili po merret me organizime humanitare për familjet skamnore.
**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** –propozoi z.Avdi Ukës, ti ndahet mirënjohje për veprimtarinë e tij patriotike, i cili ishte minator në Trepçë, dhe shqyhej për veprimtari dhe rezistencë ndaj okupatorit serb në kohën e grevës së minatorëve në vitin 1989.
**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-**deklaroi se e propozon t'i ndahet mirënjohje z.Avdi Gelën i cili ishte ushtarë dhe veteran i UÇK-së si dhe veteran i arsimit.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**propozoi të nderohet me mirënjohje post-mortum z.Shefki Pajaziti, një veteran i luftës çlirimtare, ushtarak i FSK-së i cili ka ndërruar jetë së fundmi dhe ka lënë pas veti një veprimtari të begatë patriotike dhe atdhetare.
**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-**kërkoj nga asamblistët që të respektohet lista e propozuar për mirënjohje nga shoqatat e luftës së UÇK-së, sepse ata po nderohen për kohën e luftës, dhe mos të kthehen gjërat në personale. Tutje propozoi z.Halim Aliun ish-policë mirënjohje post-mortum.
**Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit-**propozoi që t'i ndahet mirënjohje z.Avdyl Bahtirit ish-mësimdhënës dhe ish veteran i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i cili dha kontribut në themelimin e UÇK-së në Zonën Operative të Shalës.
**Behar Duraku, anëtar i kuvendit-**propozoj t'i ndahet mirënjohje z.Nazif Aliut.
**Blerina Shala, anëtare e kuvendit,** propozoj t'i ndahet një mirënjohje z.Vedat Hysenit, për kontributin e dhen në luftën çlirimtare të Kosovës.
**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit** –propozoi që t'i ndahet një mirënjohje z.Driton Zabërgja, ish-pjesëtarë i UÇK-së, veteran dhe eprorë i lartë në Policinë e Kosovës.
**Agim Bregaj, anëtar i kuvendit** –propozoj t'i ndahet mirënjohje z.Muharrem Bregaj veteran i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit** –propozoi ti ndahet mirënjohje znj. Selvete Sholla, ish asamblistët dhe veterane e arsimit.

**Kuvendi me vota "unanime" emëroj komisionin për mbarëvajtjen e procesit të votimit lidhur me ndarjen e mirënjohjeve në përbërjen si në vijim:**

Nurie Halili, PDK;
Edona Gashi, LDK;
Ymer Haradinaj LVV.

**Në vazhdim kuvendi pas votimit me vota "unanime" lidhur me propozim-vendimin për ndarjen e titullit "Qytetar Nderi" vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim, në rastin e shënimit të “Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë”, me titullin **“Qytetar nderi”** i Vushtrrisë nderohet z.Mohamed Soliman për kontributin e tij të dhënë për Komunën e Vushtrrisë si drejtor vendor i Islamik Relief Kosova.

2. Dorëzimi i këtij titull do të bëhet nga Kryetari i komunës më datë 17 qershor - “Ditën e Çlirimit të Vushtrrisë”.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë**.**

**Kuvendi pas votimit me vota “unanime” lidhur me propozim-vendimin për ndarjen e titullit “Nderi i Qytetit” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim, në rastin e shënimit të “Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë”, me titulli **“Nderi i qytetit”,** për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare nderohen:

**1.1. z. Ramadan Pllana, veprimtar i çështjes kombëtare dhe ish- burgosur politikë;**

**1.2. z. Xhemajl Pllana, veprimtar i çështjes kombëtare dhe ish-kryetar i Komunës së Vushtrrisë.**

2. Dorëzimi i këtyre dekoratave-titujve do të bëhet nga Kryetari i Komunës më datë 17 qershor- “Ditën e Çlirimit të Vushtrrisë”.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

**Kuvendi pas votimit me vota “unanime” lidhur me propozim-vendimin për ndarjen e çmimit “Emblema e Vushtrrisë” vendosi me sa vijon:**

1.Me këtë vendim në rastin e shënimit të “Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë”, me çmimin **“Emblema e Vushtrrisë”, për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare nderohen;**

**1.1.z.Gani Imeri,** ish-komandantë i Batalionit në Brigadën 141 “Mehë Uka”;

**1.2.z.Avdyl Uka,** krijues, shkrimtar dhe veprimtar i çështjes kombëtare;

**1.3.z. Avni Imer (post-mortum),** për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare, i cili ishte ndër kontribuuesit kryesor në themelimin e Zonës Operative të Shalës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës**.**

2. Dekoratat nga pika një (1) e këtij vendimi do t'i dorëzoj Kryetari i komunës në ditën e shënimit të kësaj date, më 17 qershor 2023.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Lidhur me propozim-vendimin për ndarjen e mirënjohje për nderë të 17 qershorit ditës së çlirimit të Qytetit të Vushtrrisë, kuvendi zhvilloj votim të fshehtë ku pas përfundimit të këtij procesi dhe numërimin të votave nga ana e komisionit, u konstatua se nga 34 fletëvotime 29 fletëvotime ishin të vlefshme ndërsa 4 fletëvotime ishin të pavlefshme, andaj kuvendi vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim, Kuvendi i komunës për nder të "Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë", më 17 qershor ndan këto mirënjohje:

**1.1 Avdyl Bahtiri - (post mortum),** për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare, ish pjesëtar i UÇK-së dhe ish-punëtor i dalluar në fushën e arsimit;

**1.2 Muharrem Bregaj** – (**post mortum**), për kontributin e dhënë për çlirimin e Kosovës, veteranë i UÇK-së;

**1.3 Avdi Gela -** për kontributin e dhënë si veteran i luftës së UÇK-së, si dhe veteran i arsimit;

**1.4 Avdi Uka –** për kontributin e dhënë si ish i burgosur, pjesëmarrës në Grevën e Minatorëve në vitin 1989 dhe veteran i UÇK-së;

**1.5 Dalip Maloku -** (**post mortum**), për kontributin e dhënë për çlirimin e Kosovës, veteranë i UÇK-së;

**1.6 Halim Aliu-** (**post mortum**), për kontributin e dhënë në Policën e Kosovës;

**1.7 Rifat Shaqiri-** për kontributin e dhënë, për çështjen kombëtare, veteranë i UÇK-së, dhe veteran në fushën e shëndetësisë;

**1.8 Shefki Pajaziti-(post mortum),** për kontributin e dhënë si veteran i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i cili po ashtu ka dhënë kontribut të çmuar edhe si ushtarak i Forcës së Sigurisë së Kosovës;

**1.9 –Driton Zabergja-**veteran i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, eprorë i lartë në Policinë e Kosovës;

**1.10. Bashkim Musa** – për kontributin e dhënë në organizime humanitare, organizues për ofrimin e ndihmës për familjet skamnore.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.
**3.** Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me numër të protokollit nr.79/23 i datës 30.03.2023 për Bartjen e të Hyrave vetanake të tejkaluara nga viti 2022 në vitin 2023;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota "unanime "vendosi me sa vijon:**

1. **Mallrat dhe Shërbimet.....................464,095.51 €**
2. **Shpenzimet komunale..........................3,511.39 €**
3. **Subvencionet dhe Transferet ...........57,199.58 €**
4. **Shpenzime kapitale .........................191,613.46 €**

**Totali.....................................................716,419.94 €**

**<u>1.Në kategorinë e Mallrat dhe shërbimet</u>**

Zyra e kryetarit (16024), shuma prej 30,000.00 €
Planifikimi urban dhe inspeksioni (66425), shuma prej 65,015.51 €
Infrastruktura publike (18184), shuma prej 126.080.00 €
Menaxhimi i fatkeqsive natyrore, (18468) shuma prej 50,000.00€
Administrata (92120), shuma prej 193,000.00 €

**2.Në kategorinë e Shpenzimet komunale**

Infrastruktura publike (18184), shuma prej 3,511.39 €

3.**Në kategorinë e Subvencionet dhe Transferet**

Zyra e kryetarit (16024), shuma prej 47,199.58 €
Administarta (73033), shuma prej 10,000.00 €

**4.Në kategorinë e shpenzimeve kapitale**

**Infrastruktura publike (18184), në projektet:**
Rregullimi i shtratit te lumit „Silnica" kodi (51830) shuma prej 110,000.00 €

**Planifikimi urban dhe Inspeksioni kodi (66425**)

Ndërtimi i parkut në Stanoc (I RI), shuma prej 37,800.42 €

**Bujqësia (47024), në projektet:**

Rregullimi dhe pastrimi i lumit Llap- Silnica kodi (52290), shuma prej 43,813.04 €

**Me këtë vendim është ndryshuar pika e vendimit me numër të protokollit nr.79/23 i datës 30.03.2023 për bartjen e të hyrave vetanake të tejkaluara nga viti 2022 në vitin 2023, ashtu që shuma e mjeteve financiare prej 10,000.00 € nga kategoria paga dhe mëditje është bartur në kategorinë subvencione dhe transfere në zyrën e kryetarit.**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

Ky vendim hyn fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimi të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**4.** Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me numër të protokollit nr.80/23 i datës 30.03.2023 për Bartjen e të Hyrave Vetanake nga viti 2022 në vitin 2023

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota "unanime "vendosi me sa vijon:**

Me këtë vendim bëhet bartja e të hyrave vetanake për vitin 2022 në vitin 2023 në kategoritë si në vijim:

Mallrat dhe Shërbimet.......................................................................619,076.38 €
Shpenzimet komunale...........................................................................5,000.00 €
Subvencionet dhe Transferet ...............................................................65,100.00 €
Shpenzime kapitale ..........................................................................896,440.56 €
**Totali...........................................................................................1,585,616.94 €**

**Në kategorinë Mallrat dhe shërbimet, bartja bëhet si në vijim:**

Zyra e kryetarit (16024), shuma prej **30,000.00 €**
Administrata (16324), shuma prej **10,000.00 €**
Inspektimet (16647), shuma prej **3,000.00 €**
Zyra e Kuvendit Komunal (16924), shuma prej **1,000.00 €**
Buxhetimi (17524), shuma prej **2,000.00 €**
Infrastruktura publike (18184), shuma prej **150,000.00 €**
Menaxhimi i fatkeqsive natyrore, (18468) shuma prej **50,000.00 €**
Planifikimi urban dhe inspeksioni (66425), shuma prej **75,000.00 €**
Administarta (73033), shuma prej **1,300.00 €**
Shërbimet e shëndetësisë primare (74450), shuma prej **40,000.00 €**
Shërbimet Sociale-Vushtrri (75616), shuma prej **950.38 €**

Shërbimet kulturore (85024), shuma prej **6,000.00 €**
Administrata (92120), shuma prej **208,915.00 €**
Arsimi parshkollor (92670), shuma prej **34,329.00 €**
Arsimi i mesëm i lartë (94890), shuma prej **6,582.00 €**

**Në kategorinë ekonomike shpenzimet komunale bartja e mjeteve finciare bëhet si në vijim:**
Infrastruktura publike (18184), shuma prej **5,000.00 €**

**Në kategorinë ekonomike Subvencionet dhe Transferet bartja e mjeteve finciare bëhet si në vijim:**

Zyra e kryetarit (16024), shuma prej **50,000.00 €**
Administarta (73033), shuma prej **10,000.00 €**
Shërbimet e shëndetësisë primare (74450), shuma prej **100.00 €**
Administrata (92120), shuma prej **5,000.00 €**

**Në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale bartja e mjeteve finciare bëhet si në vijim:**

**Administrata (16324), në projektin:**
Ngrohja qendrore për administratën Komunale kodi (51814), shuma prej **15,000.00 €**

**Infrastruktura publike (18184), në projektet:**
Sinjalizimi horizontal dhe vertikal rr."Dëshmorë e Kombit", "I.Qemajli", "Bekim Berisha" kodi (51822), shuma prej **19,821.00 €**
Rikonstruktimi i rrugëve te asfaltuara "2 Maji", "Hamit Hyseni", "Xhemajl Jashari" kodi (51828), shuma prej **20,000.00 €**
Ndriçimi publik në Vushtrri, Doberrlukë, Maxhunaj, Stanoc kodi (51831), shuma prej **584.00€**
Rregullimi i shtratit te lumit ,,Silnica" kodi (51830) shuma prej **110,000.00 €**
Ndërtimi i trotuareve në Vushtrri, Stanoc, Smrekonicë kodi (51821),shuma prej **1,070.00 €**
Rregullimi i sheshit "Adem Jashari" në Vushtrri, kodi (i ri), shuma prej **19,000.00 €**

**Sherbimet kulturore (85024), në projektet:**
Ndërtimi pllakave përkujtimore në Pasomë (51851), shuma prej **20,000.00 €**
Renovimi i palestës "Jeton Tërstena" (51007), shuma prej **29,901.00 €**
Ndërtimi i objektit ndihmës ne stadiumin ,,Ferki Aliu" (51847), shuma prej **20,000.00 €**

**Bujqësia (47024), në projektet:**
Projektet në bashkëfinancim me donatorë kodi (49561) ), shuma prej **82,240.00 €**
Rregullimi dhe pastrimi i lumit Llap- Silnica kodi (52290), shuma prej **60,000.00 €**

**Planifikimi urban dhe inspeksioni (66425), në projektet:**
Asfaltimi i rr. Vesekoc – Sllakovc (52188), shuma prej **80,000.00 €**
Ndërt.rrug.lokale në fshatra – Akrashticë, Vërnicë (i ri) shuma prej **166,623.00 €**

Ndërtimi i parkut ne Stanoc, kodi (i ri) , shuma prej **50,185.00 €**
Mbjellja e drunjve dekorativ kodi (49588), shuma prej **3,000.00 €**

**Shërbimet e shëndetësisë primare (74450), në projektet:**
Blerja e automjetit të terenit QKMF-Vushtrri kodi (52752), shuma prej **8,500.00 €**
Ndërtimi i zyrave administrative në QKMF (52190), shuma prej **31,000.00 €**
Ndërtimi i objektit për laborator në fsh. Lumadh (I RI), shuma prej **3,042.00 €**

**Shërbimet Rezidenciale – Vushtrri (75617), në projektin:**
Blerja e veturës për Shërbimet rezidenciale kodi (53625), shuma prej **5,000.00 €**

**Arsimi fillor, i mesëm i ulët (93690), në projektet:**
Meremetimi i SHFMU "Rexhep Musa" kodi (51870), shuma prej **3,833.00 €**
Meremetimi i SHFMU "Mihaliq" kodi (51869), shuma prej **550.00 €**
Meremetimi i SHMU,,Enver Hadari" - Smrekonicë kodi (51866), shuma prej **950.00 €**
Renovimi i shf "Ali Kelmendi" kodi (53055), shuma prej **6,355.00 €**
Meremetimi i SHMU "Adem Voca" Pasomë kodi (51864), shuma prej **1,550.00€**
Ndertimi i toaleteve ne SHMU"Emin Duraku" kodi (51854), shuma prej **44,319.56 €**
Ndertimi i fushes sportive dhe rrethojes ne SHFMU-Smrekonice kodi (I RI), shuma prej **10,270.00 €**
Ndërtimi i rrethojave në SHMU "Mustafë Shyti" Oshlan kodi (51862), shuma prej **1,564.00 €**
Ndërtimi i rrethojave ne SHFU "Rilindja" Vilanc kodi (51863), shuma prej **1,346.00 €**
Meremetimi i SHMU-1 Vushtrri kodi (I RI), shuma prej **7,950.00 €**
Renovimi i shkolles "Hajrullah Shala" në Akrashtice kodi (I RI), shuma prej **6,157.00 €**

**Arsimi i mesëm i lartë (94890), në projektet:**
Paisje për praktike profesionale SHMP "Bahri Haxha" kodi (51874), shuma prej **36,699.00 €**
Kaldaja për ngrohje qendrore "Lutfi Musiqi" SHMU II kodi (51875), shuma prej **12,939.00 €**
Ndertimi i punetorise dhe kabineteve në SHMT “Lutfi Musiqi” (i ri), shuma prej **16,992.00€**

**Me këtë vendim është ndryshuar pika e vendimit me numër të protokollit nr.80/23 i datës 30.03.2023 për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2022 në vitin 2023, ashtu që shuma e mjeteve financiare prej 10,000.00 € nga kategoria paga dhe mëditje është bartur në kategorinë subvencione dhe transfere në zyrën e kryetarit.**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

Ky vendim hyn fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimi të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**5.** Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft – Rregullores për Punën e Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë;

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-**deklaroi se kjo draft-rregullore i ka kaluar të gjitha procedurat ligjore, komisioni ka mbajtur edhe diskutim dhe dëgjim publik dhe të njëjtën e ka procedura në shqyrtim në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, ndërsa komiteti e ka dërguar për aprovim në kuvend. Po ashtu njoftoj se propozimet e bëra me shkrim nga z.Haki Maloku i janë dërguar të gjithë anëtarëve të kuvendit dhe të njëjtat kërkoj të jenë pjesë përbërëse të kësaj rregulloreje. Ndërsa tek neni 12 hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje kërkoj të shtohet një nenë i ri me këtë tekst: Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje pushojnë të vlejnë dispozitat e Rregullores për punën e kuvendit dhe organeve të tij me Nr. 71/13 e datës 04.04.2013, sa i përket neneve që rregullojnë punën e komiteteve. Kjo për faktin se rregullorja e punës së kuvendit mbetet në fuqi sa i përket punës së kuvendit, por vetëm duhet të mënjanohet dualizmi sa i përket rregullimit të punës së komiteteve.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**kërkoj që posa të kalojnë afatet ligjore dhe të merret konfirmimi i ligjshmërisë së kësaj rregulloreje të thirret një mbledhje e jashtëzakonshme për të proceduar me zgjedhjen e këtyre komiteteve tjera sipas ligjit.
**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit** –vlerësoi dhe njoftoi se kuvendi ka themeluar një komision për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për punën e kuvendit dhe organeve të tij, dhe për këtë ai kërkojë që shtyhet kjo pikë e rendit të ditës me qëllimin më të mirë që këto rregullore të harmonizohen njëra me tjetrën. Tutje ai parashtroj vërejtjet e tij duke ju referua rregullores ku thuhet se: Për çdo vendim të marrë nga Kuvendi Komunal, maksimum do të paguhen tri takime punuese të komisioneve respektive. Kjo bie në kundërshtim me Udhëzimin Administrativë nr.05/2020, për faktin se anëtarët e komiteteve tjera për punën që bëjnë kompensohen nga buxheti i komunës të cilët kompenson për gjashtë mbledhje që mbahen brenda vitit. Po ashtu edhe vlera e kompensimit nuk është në harmoni me udhëzimin administrativë.
**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-**deklaroi se nuk qëndron konstatimi sa komisioni për hartimin e kësaj rregulloreje ka tejkaluar kompetencat e tij duke intreferuar në rregulloren e punës së kuvendit, kjo për faktin se shfuqizimi i asaj rregulloreje bëhet vetëm sa i përket punës së komiteteve. Tutje konsideroj dhe vlerësoi se këto rregullore nuk kanë një gamë të përbashkët njëra me tjetrën dhe nuk shkaktojnë impakt tek njëra tjetra, andaj propozoi që kjo rregullore të del në votim dhe e njëjta të aprovohet.
**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit** –përsëri se kjo rregullore është hartuar në kundërshtim me udhëzimet administrative dhe për këto ai ka propozuar të bëhet një rregullore e përbashkët për kuvendi dhe komitete. Në të kundërtën nëse votohet në këtë formë atëherë ai do ti drejtohet MAPL-së duke e ankimuar këtë rregullore.
**Ismet Gashi, udhëheqës i Zyrës Ligjore-**tha se kjo rregullore nuk bie ndesh me Udhëzimin Administrativ për formimin e komiteteve të përhershme sepse paragrafi që flet për kompensimin ju referohet komisioneve ad-hoc që i formon kuvend për lehtësimin e punës së tij dhe nuk bëhet fjalë për komitetet tjera.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**tha se kjo rregullore nuk bie ndesh me asnjë ligj të fushë së vetëqeverisje lokale dhe shtoj se themelimi i këtyre komiteteve tjera nuk ka të bëj fare me komitetet e përhershme. Tutje shtoi se Komuna e Vushtrrisë është vonuar shumë në themelimin e komiteteve tjera në fushat përkatëse që do ta japin kontributin e tyre për zhvillimin e komunës. Kërkoj që kjo rregullore të aprovohet dhe të procedohet tutje themelimi i këtyre komiteteve.

**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit-**pyeti zyrtarin ligjor se ku janë bazuar kur kanë vendosur që komisionet t' i mbajnë vetëm tri takime në vit, sepse në këtë rang hynë edhe Komisioni për zgjidhjen e Këshillave Lokal dhe ai për Verifikimin e Pronës Komunale.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendit pas votimit me 27 vota "për" 2 vota "kundër" aprovoj Draft – Rregulloren për Punën e Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, me propozimet e bëra në formë të shkruar nga z.Haki Maloku.**

**6.** Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2022;

**7.** Shqyrtimi i Propozim-vendimit për kompensimin të anëtarëve të Komisionit për verifikimin e procesit të dhënies në shfrytëzimin të pronës komunale;

**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-**sqaroi se mjetet financiare për zbatimin e këtij vendimi do të merren nga kategoria paga dhe mëditje.
**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit –**deklaroi se shuma e kompensimit për mbledhje do të jetë 30 € për anëtar.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota "unanime "vendosi me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim, lejohet kompensimi i anëtarëve të komisionit kuvendar për verifikimin e procesit të dhënies në shfrytëzim të pronës komunale.

**2.** Lartësia e kompensimit për çdo takim caktohet në shumën prej 30€ për anëtar të komisionit, në bazë të procesverbalit për mbajtjen e takimit.

**3.** Mjetet financiare për zbatimin e këtij vendimi do të sigurohen nga kategoria paga dhe mëditje.

**4.** Kompensimi i këtyre komisioneve do të bëhet konform legjislacionit në fuqi.

**5.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

**6.** Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Mbledhja përfundoi në ora: 14:30.**

| | |
|---|---|
| **Bastri Duraku** | **Melihate Basholli-Latifi** |
| ________________ | ____________________________ |
| **Procesmbajtës** | **Kryesuese e Kuvendit** |

| REPUBLIKA E KOSOVËS | KOMUNA VUSHTRRI |
|---|---|

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | 13.06.2023 |
| **PËR/ZA/TO:** | KPF dhe Kuvendin Komunal |
| **PËRMES;** | Kryetari i Komunës Ferit Idrizi__________ |
| **NGA/OD/FROM;** | Abit Abiti, ZKF__________ |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | Korniza Afatmesme e Buxhetore 2024-2026 |

Bazuar në Qarkoren Buxhetore 2024/01, e kemi përgatitur Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe po e dërgojmë për miratim në Kuvendin Komunal. Ky dokument është dokumenti bazë për planifikimin e Buxhetit Komunal, përmban prioritetet strategjike lidhur me caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve. Korniza Afatmesme Buxhetore 2024-2026 është në përputhje me udhëzimet e dhëna me Qarkoren Buxhetore 2024/01 të nxjerra nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve.

Shtojcë :

- Korniza Afatmesme e Buxhetore

REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA VUSHTRRI

# KORNIZA AFATMESME BUXHETORE

## 2024 - 2026

## KOMUNA E VUSHTRRISË

KAB 2024-2026 bëhet përfundimtar pas miratimit të buxhetit në Kuvendin Komunal

## Përmbajtja

I. Hyrje
II. Deklarata e prioriteteve afatmesme
III. Vizioni i komunës
IV. Misioni i komunës
V. Korniza fiskale komunale
VI. Të hyrat komunale dhe parashikimi afatmesëm 2024-2026
VII. Plani komunal i bashkëfinancimit sektorial me ministritë e linjës dhe donatorët
VIII. Analiza gjinore
IX. Informacionet sipas programeve

**KAB 2024-2026 bëhet përfundimtar pas miratimit të buxhetit në Kuvendin Komunal**

# I. Hyrje

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2024-2026 paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet Buxheti Vjetor për vitin 2024. Me këtë dokument përcaktohen grantet qeveritare për financimin e komunave për vitin 2024 dhe orientimet për vitet 2025-2026, bazuar në prioritetet strategjike të Qeverisë në fushën e marrëdhënieve fiskale ndërqeveritare. Po ashtu, ky dokument përcakton nivelin e të hyrave vetanake të komunave për vitin fiskal 2024 si dhe parashikimin afatmesëm 2025-2026. Parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2024, bazohen në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL) dhe Tabelën 1 të projeksioneve makro-fiskale, të përgatitur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve siç specifikohet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP). Procesi i buxhetit komunal merr parasysh këto aspekte: - Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël, - Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës, - Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale, si dhe - Përcaktimi i strukturës së shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve. Projektet kapitale shumëvjeçare duhet të raportohen në sistemin e Projekteve të Investimeve Publike (PIP) bazuar në performancë.

Fazat e përmbledhura të KAB-it Komunal dhe afatet kohore




**KAB 2024-2026 bëhet përfundimtar pas miratimit të buxhetit në Kuvendin Komunal**

## II. Deklarata e prioriteteve afatmesme

Bazuar në nevojat momentale të popullatës, resurset në dispozicion dhe përvoja, Komuna e Vushtrrisë është e pozicionuar për të gjeneruar një strategji të re zhvillimore që synon në përsosjen e strukturës së saj ekonomike, rritjen e punësimit, dhe krijimin e një ambienti për përshpejtimin e përgjithshëm të zhvillimit lokal, prodhimtarisë, bujqësi moderne dhe turizëm. Kjo strategji e re e zhvillimit ekonomik siguron një vizion për Komunën e cila përfshinë synimet specifike për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe ato të mesme (NVM) dhe të bujqësisë, si dhe programet dhe projektet për ti realizuar këto synime. Komuna e Vushtrrisë ka një shtrirje të bizneseve shumë të sukseshme dhe aktive në tregun e Kosovës dhe tregun e jashtëm që e ushtrojnë aktivitetin afarist. Në të vërtetë, Komuna e Vushtrrisë tanimë është duke punuar për të përsosur ambientin për biznes duke punuar në formimin e Zonave Ekonomike si zona komerciale, artizanale dhe prodhuese, duke përfshirë këtu bizneset e mëdha dhe të vogla, ndërmarrësit dhe organizatat aktive në Komunë kanë bërë një ndryshim në mendimin rreth zhvillimit ekonomik si rezultat i pjesëmarrjes në këtë qasje të zhvillimit komunal. Këto synimet kërkojnë një riorganizim të konsiderueshëm, ndryshim në proceset e punës në institucionet e qeverisjes lokale, krijimin e mekanizmave të rinj për bashkëpunim ndermes sektorit publik dhe privat, dhe formimi dhe ndërtimi i kapacitetit të institucioneve dhe organizatave të reja që do të marrin përgjegjësinë për zhvillim ekonomik. Për të përmbushur këto synime ambicioze, Komuna e Vushtrrisë duhet të mobilizojë dhe angazhoj të gjitha resurset që janë në dispozicion, të cilat resurse qartazi do të jenë të pamjaftueshme për implementimin e tërë planit. Si rrjedhim, Komuna do të kërkoj përkrahje domethënëse nga nivelet tjera të qeverisjes në Kosovë dhe organizatat ndërkombëtare në formë të diturisë, përvojës, dhe ndihmës teknike dhe financiare për të transformuar vizionet dhe synimet e saja në realitet brenda periudhës më të shkurtër kohore të mundshme.

Procesi i përgatitjes së parashikimit të shpenzimeve (kufijve buxhetorë) për periudhën 2024-2026 duhet të lidhet me parimet e përgjithshme të Qeverisë së Kosovës të përcaktuara me Kornizën Afatmesme Buxhetore, e ato janë:

- Përputhje me politikat prioritare të Qeverisë, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim (SKZH),
- Planit Kombëtar për Zhvillim (PKZH), Programin e Reformave Ekonomike (PRE) 2023-2025,
- Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit si dhe Programin e Qeverisë 2021-2025.
- Alokimin e shpenzimeve të cilat janë më efektive në realizimin e objektivave të politikave të Qeverisë;
- Rritje të cilësisë dhe besueshmërisë në procesin buxhetor si dhe ndërlidhje më të mirë ndërmjet politikave dhe buxhetit.
- Ekzekutim më të lartë të shpenzimeve në krahasim me planifikimin e tyre, me theks të veçantë në shpenzimet kapitale, duke realizuar synimet specifike prioritare
- Ndërlidhjen me financimin e jashtëm të ofruar nëpërmjet IPA dhe kanaleve të tjera.

## Pozita gjeografike e Komunës së Vushtrrisë

Vushtrria si komunë ka pozitë të përshtatshme gjeografike dhe ekonomike. Territori i Komunës së Vushtrrisë gjendet në pjesën veriore të Kosovës. Komuna shtrihet në drejtim veri-jug (gjatësia maksimale afro 34km) dhe diç më e zgjeruar në mes (gjerësia maksimale afro 23 km) me një gjatësi të vijës kufitare prej afro 104.5 km. Territori i komunës gjendet në mes të këtyre koordinatave gjeografike:
X1 : 200 50' 09'' dhe X2 : 210 07' 05'';
Y1 : 420 42' 20'' dhe Y2 : 420 55' 12''.
Territori i Komunës së Vushtrrisë zë afro 3.2% të sipërfaqes të tërë territorit të Republikës së Kosovës. Komuna e Vushtrrisë në veri kufizohet me Mitrovicën, në lindje me Podujevën, në jug me Obiliqin, në jugperëndim me Drenasin dhe në perëndim me Skenderajn. Në përgjithësi relievi i Komunës së Vushtrrisë është i butë dhe kodrinor. Nëpër territorin e Komunës së Vushtrrisë rrjedh lumi Silnica, me disa degë të tij dhe një pjesë e rrjedhjes së poshtme të lumit Llap. Pas Drinit të Bardhë, Silnica është lumi me supërfaqen më të madhe ujëmbledhëse prej 2912 km2. Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, Komuna e Vushtrrisë ka 69870 banorë të organizuar në 11866 ekonomi familjare.

## Gjendja aktuale në ekonomi

Bizneset aktive të Komunës së Vushtrrisë llogaritet të jenë 4 172. Në kohën e fundit vërehet një trend pozitiv në rritjen e industrisë përpunuese- prodhuese. Prej këtyre bizneseve kryesisht dominon industrisë përpunuese- prodhuese, pastaj bizneset shërbyese, tregtia e kështu me radhë (Shih tabelën më poshtë). Këto subjekte ekonomike punësojnë një numër të konsiderueshëm të punëtorëve. Bazuar në të dhënat e Zyrës për regjistrim të bizneseve në komunë të cilat janë marrë në ARBK, nga bizneset të cilat operojnë në Komunën e Vushtrrisë, një pjesë e konsiderueshme e tyre merren me veprimtari tregtare 20% , në sektorin e shërbimeve (hotele dhe restorante) 5.66% , industri përpunuese 21% etj. Krahasuar me vitin e kaluar vërehet një rritje e lehtë në përqindjen e industrisë përpunuese.
Struktura e veprimtarive ekonomike bazuar në të dhënat e marra nga ARBK

| | Vushtrri |
|---|---|
| A - BUJQËSIA, PYLLTARIA DHE PESHKIMI | 156 |
| B - MINIERAT DHE GURORET (INDUSTRIA NXJERRËSE) | 2 |
| E - FURNIZIMI ME UJË; KANALIZIMI, AKTIVITETET E MENAXHIMIT DHE TË TRAJTIMIT TË MBETURINAVE | 14 |
| F - NDËRTIMTARIA | 274 |
| H - TRANSPORTI DHE MAGAZINIMI | 151 |
| I - AKOMODIMI DHE SHËRBIMI USHQIMOR | 233 |
| J - INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI | 94 |
| K - AKTIVITETET FINANCIARE DHE TË SIGURIMIT | 20 |
| L - AKTIVITETET E PATUNDSHMËRISË | 17 |
| M - AKTIVITETET PROFESIONALE, SHKENCORE DHE TEKNIKE | 205 |

| | |
|---|---|
| N - SHËRBIMET ADMINISTRATIVE DHE MBËSHTETËSE | 189 |
| O - ADMINISTRIMI PUBLIK DHE MBROJTJA; SIGURIMI SOCIAL I DETYRUESHËM | 8 |
| P - ARSIMI | 75 |
| Q - AKTIVITETET E SHËNDETIT TË NJERIUT DHE TË PUNËS SOCIALE | 120 |
| R - ARTET, ARGËTIMI DHE REKREACIONI | 59 |
| S - AKTIVITETET E TJERA SHËRBYESE | 849 |
| G - TREGTIA ME SHUMICË DHE PAKICË; RIPARIMI I MJETEVE MOTORIKE DHE MOTOÇIKLETAVE | 820 |
| D - FURNIZIMI ME RRYMË, GAZ, AVULL DHE AJËR TË KONDICIONUAR | 8 |
| C - INDUSTRIA PËRPUNUESE | 878 |
| **Grand Total** | **4,172** |

**Burimet natyrore**

Komuna e Vushtrrisë është mjaft e pasur me pasuri natyrore. Kompleksi i maleve të Çyqavicës është i pasur me florë dhe faunë të zhvilluar si dhe me reliev karakteristik të llojit të veçantë. Në të njëjtin kompleks hasim edhe në llojllojshmërinë e shkëmbinjve dhe mineraleve të pastudiuara sa duhet. Komuna e Vushtrrisë, përveç të tjerash, është e krahasuar edhe me shumë vende me potenciale të mineraleve dhe mundësive për eksploatime druri dhe guri, si:

- Duboc - magnezit e porcelan;
- Bivolak, Zhilivodë, Beçuk, Stroc, Gllavatin - thëngjill druri
- Pasomë, Tërllobuq, Smrekonicë dhe Shalë - eksploatimi i gurit
- Gumnishtë dhe Boshlan - pasuri të plumbit dhe zinkut
- Bajnskë - ujë termo-mineral
- Gjelbishtë dhe Gojbulë - ujë mineral
- Karaçë - burime minerale

## III.Vizioni i komunës

Komuna e Vushtrrisë është mjedis i përshtatshëm për ndërmarrësi dhe ka ndërtuar strukturë funksionale ndërlidhëse ndërmjet sektorëve të bujqësisë, blegtorisë, edukimit dhe ndërmarrësisë. Vushtrria apo "Vicianum" është "shtëpi" e bizneseve dhe është identifikim I qendrës së dikurshme historike dhe tregtare.

## VI. Misioni i Komunës

Si zonë e veçantë historike do të marrë identitetin e saj të dikurshëm si qendër për bizneset prodhuese dhe aktivitetet tjera të biznesit duke rritë mirëqenien ekonomike dhe sociale për të gjithë

qytetarët e saj. Zhvillimi ekonomik lokal do të arrihet si bashkëveprim i zhvillimit të ambientit biznesor, prodhimtarisë dhe kulturave bujqësore, me sistem arsimor të harmonizuar me ekonominë lokale duke siguruar standard të mirëqenë jetësor dhe social. Administrata komunale do të jetë në shërbim të plotë të qytetarëve dhe bashkëpunëtor I akterëve të ekonomisë lokale.

Bazuar në dokumentet strategjike, Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2024-2026 të Qeverisë së Kosovës dhe prioriteteve bazë të saj, si dhe Qarkoren Buxhetore Komunale 2024/01 të lëshuar nga Ministria e Financave dhe Transfereve e Qeverisë së Republikës së Kosovës, për tri vitet e ardhshme. Synimi i Komunës së Vushtrrisë është që të jetë qendër e zhvillimit të qëndrushëm ekonomik me urbanizëm modern dhe shërbime efikase e kualitative, e integruar në proceset rajonale dhe ndërkombëtare si një qendër e kulturës së pasur, arsimimit, jetës sportive dhe synon një kualitet më të mirë të jetesës për qytetarët e saj.

## *SYNIMET DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE*

**Vizioni**: Në drejtorinë tonë ne punojmë për të zbatuar legjislacionin përkatës shëndetësor, për të siguruar që shërbimet e mëposhtme primare shëndetësore për të gjithë qytetarët ofrohen në fushat e mjekësisë familjare, stomatologjisë, farmacisë, shërbimet laboratorike dhe kujdesin mjekësor emergjent. Ne i ofrojmë këto shërbime duke punësuar staf profesional dhe duke e trajnuar stafin mjekësor që vepron në Qendrën kryesore të mjekësisë familjare . Përveç kësaj, ne po ashtu do të punojmë për të siguruar nivelet e duhura të higjienës që nga kryerja e inspektimeve sanitare për ujin e pijshëm, bizneset prodhuese, përpunimin ose shitjen e ushqimit dhe atyre kompanive që merren me trajtimin e mbeturinave. Gjithashtu synojmë për të siguruar mbështetje të shërbimit social në pikat më të rrezikuara të bashkësisë sonë dhe këtë e bëjmë përmes identifikimit të rasteve sociale, dhe duke vlerësuar nevojën rast për rast.

| Indikatori | 2020 | 2021 | 2022 |
|---|---|---|---|
| % e fëmijëve nën moshën 1 vjeçare që e përfundojnë rrethin e parë të imunizimit | 95% | 96% | 98% |
| Renovimi i objekteve shëndetësore; % e zbatimit të planit 3 vjeçar për përmirësimin e objekteve shëndetësore | 100% | 100% | 100% |
| Raporti i numrit të doktorëve me numrin e qytetarëve | 1 doktor në 2500 banorë | 1 doktor në 2300 banorë | 1 doktor në 2000 banorë |
| Numri i fëmijëve shkollor që kryejnë kontrolle dentare përmes vizitave në shkolla, vetëm gjatë kontrolleve sistematike të klasave të para që kryhen çdo vit. | 1070 nxënës | 1100 nxënës | 1200 nxënës |
| Numri i shkollave që marrin pjesë në fushatën për vetëdijesimin dentar, vetëm gjatë kontrolleve sistematike të klasave të para që kryhen çdo vit | 1070 nxënës | 1100 nxënës | 1200 nxënës |

**Planifikimi Urban dhe Mjedisit**

**Misioni**: Mjedis më tërheqës natyror dhe përdorim më efektiv i tokës dhe ndërtesave në Kosovë.
**Vizioni**: Planifikon zhvillimin hapësinor dhe urbanistik, përcjell dhe studion zhvillimin hapësinor brenda territorit të komunës (sipas metodologjisë bashkëkohore);
- Harton Planin Zhvillimor të Komunës, Harten Zonale Komunale dhe Planet Rregulluese të Hollësishme;
- Ofron sugjerime dhe mendime lidhur me procedurën për miratimin e tyre dhe propozon realizimin e tyre;
- Mbledh, përpunon dhe plotëson dokumentacionin e zhvillimit hapësinor, në harmoni me Ligjin për Planifikimin Hapësinor dhe dispozitat tjera të nxjerra në bazë të tij; Ligjit për Ndertim dhe aktet tjera nënligjore që rregullojnë fushën e ndërtimit dhe planifikimit .

- Bashkëpunon me të gjitha subjektet pjesëmarrëse në planifikimin dhe zhvillimin e qytetit dhe të komunës për hartimin e planeve hapësinore;
- Merret me planifikimin urban dhe rural të komunës dhe të shfrytëzimit të tokës;
- Bashkëpunon rreth konceptit të zgjidhjeve dhe përmbajtjeve të planeve rregulluese urbane;
- Përcjell planifikimin urbanistik dhe projektimin si dhe merret me zbatimin e tyre;
- Përgatit plane të detajuara urbanistike, projektet urbanistiko-arkitektonike për lagje dhe tërësi të caktuara të qytetit dhe komunës;
- Harton programe, detyra projektuese me ndihmën e ekspertëve të përzgjedhur për organizimin e konkurseve urbanistko-arkitektonike në nivel vendor dhe ndërkombëtar;
- Përgatit dhe ofron informacione bazë dhe dokumente për përgatitjen, miratimin apo ndryshimin e planeve hapësinore, urbanistike, rregulluese dhe planeve të detajuara të qytetit dhe të komunës;
- Propozon dhe miraton kriteret për vendosjen e objekteve të përkohshme, pajisjeve dhe elementeve mikro-urbane në territorin e qytetit dhe komunës;
- Merret me hartimin e legjislacionit, ekspertizave analitike, veprimtarive të tjera në fushat e caktuara të planifikimit hapësinor dhe urban;
- Propozon dhe zbaton programin për hapësirën e komunës;
- Jep pëlqime për ndërtimin e objekteve të rëndësisë lokale dhe zhvillimeve të tjera;
- Organizon dhe kontrollon dokumentacionin teknik;
- Organizon dhe cakton grupin profesional për mbikëqyrje, pranime teknike të objekteve ndërtimore dhe shërbime tjera përkatëse;
- Lëshon vendime dhe vërtetime për gjendjen e objekteve ekzistuese;
- Konstaton dhe delegon informatat për objektet e ndërtuara në mospërputhje me ligjet ndërtimore, standardet dhe dokumentacionet urbanistike në fuqi;
- Jep leje për përdorimin e objekteve të përfunduara;
- Inicon programe për ndërtimin e infrastrukturës dhe objekteve kapitale në territorin e komunës;
- Bashkëpunon me subjektet përkatëse komunale në fushën e rregullimit të tokës ndërtimore;
- Propozon krijimin e zonave të tokës së ndërtimit dhe përpunon lokacionet për dhënien e tokës në shfrytëzim;
- Zbaton programet e sektorëve të tjerë të Administratës komunale, në fushën e ndërtimit të infrastrukturës dhe objekteve kapitale, si dhe vendimet komunale nga përgjegjësia e kësaj drejtorie;
- Përgatit propozimet e Rregulloreve dhe akteve tjera nga lëmi i ndërtimit, planifikimit, projektimit dhe rregullimit hapësinor;
- Udhëzon dhe orienton subjektet nga fusha e ndërtimit, bashkëpunon me subjektet udhëheqëse dhe personat juridikë nga fusha e ndërtimit, ofron të dhënat dhe informata të tjera bazike profesionale të nevojshme për punën e udhëheqjes komunale;
- Koordinon dhe kryen punët procedurale nga lëmi i ndërtimit;
- Kryen detyra të tjera të deleguara nga ligji dhe rregulloret tjera në fuqi;
- Harton projektprogramin për vlerësimin e gjendjes ekzistuese të tokës ndërtimore të komunës;
- Propozon dhe zbaton programin e veçantë për rregullimin e gjendjes ekzistuese të tokës ndërtimore të komunës;
- Organizon dhe trajnon grupet profesionale dhe kapacitetet njerëzore për procedurën e legalizimit.
- Organizon dhe cakton grupin profesional për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave (dokumentacioneve) për legalizim;
- Kontrollon dokumentacionin teknik në harmoni me ligjet ndërtimore, standardet, dokumentacionet urbanistike në fuqi, si dhe me rregulloren dhe manualin për legalizim;
- Shqyrton programe për ndërtimin e infrastrukturës dhe objekteve kapitale në tërësitë hapësinore ilegale;
- Koordinon dhe kryen punët procedurale nga lëmi i ndërtimeve ilegale;
- Kryen edhe detyra të tjera në pajtim me dispozitat ligjore.

| Indikatori | 2020 | 2021 | 2022 |
|---|---|---|---|
| Koha për lëshimin e lejes ndërtimore | 30-45 | 30-45 | 30-45 |
| % e lejeve të lëshuara brenda afatit ligjor | 70 | 80 | 85 |

**Bujqësi, pylltari dhe zhvillimi rural**

**Misioni:** Për të krijuar ambient tërheqës, bashkësi familjare ekonomikisht të qëndrueshme në zonat rurale, duke përfshirë të gjitha grupet pa dallim etniteti, feje apo gjinie për një ambient të qëndrueshëm socio-ekonomik dhe duke promovuar praktikat e mira bujqësore.

**Vizioni:** Qëllimi ynë kryesor është për të siguruar që numri maksimal i familjeve në zonat e fshatrave dhe sidomos fermat familjare do të zhvillohen dhe mbajnë një bazë ekonomike të qëndrueshme brenda komunës. Ne planifikojmë dhe ta bëjmë këtë duke mbrojtur tokën bujqësore përmes mbajtjes së një shënimi/të dhënave të sakta të përdorimit të tokës bujqësore dhe pronësisë së këtyre pronave. Ne do të bashkëpunojmë me bankat komerciale, për të shqyrtuar format e kreditimit për fermerët dhe për të stimuluar dhe promovuar blerjet blegtorale dhe zhvillimin bujqësor në këto mjedise. Ne gjithashtu bashkëpunojmë ngusht me ekspertë të IADK që të ofrojmë këshilla për fermerë për të zhvilluar kapacitetet prodhuese, ngritjen e fuqisë se tyre konkurruese në treg, duke promovuar praktikat më të mira bujqësore. Ne do të promovojmë mbrojtjen e mjedisit tonë natyror dhe të zbatojmë legjislacionin përkatës në fushën e mjedisit dhe ruajtjes së pyjeve.

| Indikatori | 2020 | 2021 | 2022 |
|---|---|---|---|
| % e tokës bujqësore që është duke u kultivuar | caku për vitin 2020 | caku për vitin 2021 | caku për vitin 2022 |
| 5986 ha | 6083 ha | 6154 ha | 6250 ha |
| | | | |

**Arsimi dhe Shkenca**

**Misioni:** Çdo personi do duhet t'i mundësohet arsimi, sporti dhe kultura nëpërmjet përvojave të të nxënit pozitiv dhe do të stimulohet për arritjet e tij / saj të plota, veprime të cilat do ju japin atyre besim dhe do të gjejnë vet përmbushje me atë që merren.

**Vizioni:** Qëllimi ynë është që të sigurojmë qasje të barabartë për të gjithë fëmijët brenda komunës, në sistemin e arsimit cilësor, parashkollor, fillor dhe atë të mesëm. Ne gjithashtu do të mbështesim sigurimin e edukimit të mëtejmë për të rriturit dhe për ta bërë këtë kemi siguruar zbatimin e rregullores kombëtare, legjislacionin e duhur arsimor dhe politikat gjegjëse si rezultat. Po ashtu marrim pjesë në përzgjedhjen e stafit dhe drejtorëve të shkollave për të siguruar se profesionistët dhe të kualifikuarit janë të punësuar për të mësuar qytetarët tanë, të rinjtë dhe të moshuarit dhe njëherit i mbajmë të gjitha shënimet e nevojshme komunale të arsimit dhe statistikat për të matur nivelin e cilësisë se arsimit që ofrohet nga komuna. Gjithashtu komunikojmë hapur me publikun për të gjitha çështjet që lidhen me politikën e arsimit dhe të procesit përbrenda komunës, si dhe bëjmë promovimin e sportit dhe kulturës me organizimin e ngjarjeve sportive dhe kulturore, përkrahjen e organizatave sportive dhe drejtimin e qendrës komunale të kulturës.

| Indikatori | 2020 | 2021 | 2022 |
|---|---|---|---|
| % e fëmijëve që arrijnë moshën për të filluar shkollën | 8 % | 7.93 % | 7.91% |
| % e nxënësve që kalojnë provimin shtetëror | 53.95 % | 54.33% | 55.05% |
| % e shkollave që kanë kaluar nga sistemi me 3 ndërrime në sistemin me 2 ndërrime | 100 % | 100 % | 100 % |
| Raporti i numrit të mësuesve me numrin e fëmijëve parashkollorë, fillorë dhe të mesëm. | Niveli o, 1:17.4<br>Niv. 1 dhe 2 1:16%<br>Niveli 3, 1:17 | Niveli o, 1:17.4<br>Niv. 1 dhe 2 1:16%<br>Niveli 3, 1:17 | Niveli o, 1:17.4<br>Niv. 1 dhe 2 1:16%<br>Niveli 3, 1:17 |

**Administrata dhe Personelit**

Administrata dhe Personeli

Misioni: Drejtoria e Administratës ka si mission ofrimin e të gjitha shërbimeve që janë në kompetencë dhe që mund të kryhen në këtë drejtori. Është një trend i ngritjes së vazhdueshme të efikasitetit dhe i ofrimit të shërbimeve sa më cilësore dhe më efektive, në mënyrë që t'I plotësojmë dhe t'u përgjigjemi kërkesave të qytetarëve të Vushtrrisë dhe të gjithë palëve të interesuara të cilët i janë drejtuar komunës së Vushtrrisë

Vizioni: Ne përpiqemi të jemi një Komunë dinamike që përcakton trendet, duke ofruar shërbime cilësore të përgjegjshme ndaj kërkesave dhe sfidave të komunitetit dhe mandatit tonë kushtetues, në të cilin të gjithë palët e interesuara mund të marrin pjesë në harmoni dhe dinjitet.
Përmes shërbimeve që i ofrojmë si Drejtori dhe shërbimeve të tjera të cilat pretendojmë t'i vëmë në funksion, përpiqemi t'ua bëjmë sa më të lehtë qasjen në shërbimet tona qytetarëve, si dhe funksionimin sa më efektiv dhe efecient nga ana jonë.
Vizioni ynë si drejtori është qe me punën dhe profesionalizmin tone t'ua lehtësojmë marrjen e shërbimeve qytetareve, si dhe te jemi transparent e llogaridhënës ne punën tone.

| Indikatori | 2020 | 2021 | 2022 |
|---|---|---|---|
| Lëshimi i dokumenteve të gjendjes civile | 60,000 | 60,000 | 60,000 |
| Numri i kërkesave të pranuara nga QSHQ | 70,000 | 70,000 | 70,000 |

**Buxheti dhe financat**

**Misioni:** Arritja e niveleve më të larta të ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetiti në menaxhimin e fondeve komunale.
**Vizioni:** Nëpërmjet planifikimit të duhur dhe menaxhimit të resurseve komunale, ne përpiqemi që të promovojmë vlerën për ofrimin e të gjitha shërbimeve për qytetarët e Vushtrrisë. Ne mbikëqyrim planifikimin dhe zbatimin e buxhetit komunal për të siguruar pajtueshmërinë me të gjithë legjislacionin e financave, statutit dhe rregulloreve tjera përkatëse. Ky veprim përfshin zbatimin e rregullores mbi tarifat dhe pagesat, veprime që lidhen me mbledhjen e tatimit në pronë. Ne gjithashtu do i përgatitim të gjitha raportet financiare dhe llogaritë vjetore në përputhje me kërkesat statutore komunale.

**Republika e Kosovës** **Kuvendi i Komunës- Vushtrri**

**Komiteti për Politikë dhe Financa**

Në bazë të nenit 52, paragrafi 2 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 54, paragrafi 5, të Statutit të Komunës, si dhe Qarkores Buxhetore të Ministrisë së Financave 2020/01 për Komuna, Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa, pas konsultimit me Kryetarin e Komunës më ________**2023** përcakton:

## KALENDARIN KOHOR
## PËR MBAJTJE TË TAKIMEVE PUBLIKE ME QYTETARË

1. Me këtë kalendar kohor, caktohen grupet punuese, datat, koha dhe vendi i mbajtjes së takimeve publike me qytetarë për përgatitjen e draft-buxhetit të komunës dhe projekteve prioritare për vitin 2024 në Komunën e Vushtrrisë.

2. Anëtari i Komitetit për Politikë dhe Financa do të jetë kryesues në secilin takim publik.

3. Drejtoria për Shërbime Publike duhet të sigurojë automjetet zyrtare për zyrtarët që do të marrin pjesë në këto takime sipas orarit të përcaktuar.

4. Drejtoria për Buxhet dhe Financa të përgatisë një raport për secilin fshat, lidhur me obligimet e kryera dhe të pakryera të tatimit në pronë, ku do të bëhet prezantimi i raportit para qytetarëve në rastin e diskutimit të buxhetit dhe planifikimit të projekteve prioritare, duke dhënë shpjegime se pagesat e tatimit në pronë do të kthehen në investime për projektet kapitale në të ardhmen në ato lokalitete.

5. Zyra për informim e komunës, obligohet që të informojë qytetarët përmes mjeteve të informimit publik, konform me rregullativën ligjore për informim publik.

6. Obligohet kryesuesi i secilit takim publik që të sigurojë procesmbajtësin, i cili do të përfshijë në procesverbal kërkesat, gjegjësisht propozimet e qytetarëve.

7. Procesverbalet e nënshkruara nga kryesuesi i takimit dhe procesmbajtësi duhet të dorëzohen me nga një ekzemplar në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe në Sekretarinë e Kuvendit.

8. Ky kalendar ju dërgohet të gjithë bartësve të aktiviteteve, si dhe Arkivit të sekretarisë.

**KALENDARI KOHOR**
**PËR MBAJTJE TË TAKIMEVE PUBLIKE ME QYTETARË**

| DATA | KOHA | VENDI | GRUPET PUNUESE |
|---|---|---|---|
| 27.06.2023 | 17:00 | Stroc (shkolla e fshatit) | Ilmi Azemi - kryesues<br>Albanez Tahiraj<br>Behar Duraku<br>Bastri Duraku<br>Abit Abiti<br>Zoja Hajrizi |
| 27.06.2023 | 19:00 | Druar (shkolla e fshatit) | Ilmi Azemi - kryesues<br>Albanez Tahiraj<br>Behar Duraku<br>Bastri Duraku<br>Zoja Hajrizi<br>Abit Abiti |
| 06.07.2023 | 17:00 | Novolan (shkolla e fshatit) | Melihate Basholli - kryesuese<br>Nurije Halili<br>Qemajl Hasani<br>Albulena Tahiri<br>Benjamin Shala |
| 07.07.2023 | 19:00 | Duboc (shkolla e fshatit) | Nurije Halili - kryesuese<br>Besim Demiri<br>Qemajl Hasani<br>Nexhmedin Rashica |
| 07.07.2023 | 17:00 | Pantinë (shkolla e fshatit) | Sylejman Meholli - kryesues<br>Naxhije Muzaqi<br>Benjamin shala |
| 07.07.2023 | 17:00 | Smrekonicë (shkolla e fshatit) | Lorik Maxhuni - kryesues<br>Nexhat Merovci<br>Fortuna Krasniqi<br>Isuf Jashari |
| 10.07.2023 | 17:00 | Samadrexhë (shkolla e fshatit) | Agron Përçuku - kryesues<br>Lutfi Gërguri<br>Medina Bunjaku<br>Refik Maloku |
| 10.07.2023 | 17:00 | Maxhunaj (shkolla e fshatit) | Lorik Maxhuni - kryesues<br>Abit Abiti<br>Ergin Sunguri |
| 11.07.2023 | 19:00 | Nedakoc (shkolla e fshatit) | Ilmi Azemi - kryesues<br>Abit Abiti<br>Maliq Ferizi<br>Naim Ferizi |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **11.07.2023** | **20:30** | **Prelluzhë (shkolla e fshatit)** | **Ilmi Azemi - kryesues**<br>**Abit Abiti**<br>**Ergin Sunguri**<br>**Branislav Vuksanovic** |
| **11.07.2023** | **17:00** | **Stanoc i Epërm (shkolla e fshatit)** | **Nurije Halili – kryesuese**<br>**Faton Hyseni**<br>**Mensur Kasumi**<br>**Ymer Haradinaj**<br>**Agim Bregaj**<br>**Lindita Haradinaj** |
| **11.07.2023** | **19:00** | **Dumnicë e Llugës (shkolla e fshatit)** | **Fakete Dushi - kryesuese**<br>**Lorik Maxhuni**<br>**Abit Abiti**<br>**Albanez Tahiri**<br>**Izet Miftari** |
| **12.07.2023** | **16:30** | **Skromë (shkolla e fshatit)** | **Ilmi Azemi - kryesues**<br>**Isuf Jashari**<br>**Basri Breznica**<br>**Bujar Pllana** |
| **12.07.2023** | **17:45** | **Gojbulë (shkolla e fshatit)** | **Alban Bajrami - kryesues**<br>**Basri Breznica**<br>**Medina Bunjaku** |
| **12.07.2023** | **17:00** | **Me grupet e ndryshme të grave**<br><br>**Salla e Kuvendit Komunal** | **Melihate Basholli - kryesuese**<br>**Remzije Zekolli**<br>**Hyrije Uka**<br>**Fortuna Krasniqi**<br>**Medina Bunjaku** |
| **14.07.2023** | **19:00** | **Me sportistë, rini dhe komunitetin artistik**<br><br>**Salla e Kuvendit Komunal** | **Fatmire Cecelia - kryesuese**<br>**Medina Bunjaku**<br>**Zyra e Kryetarit**<br>**Benjamin Shala** |
| **14.07.2023** | **14:00** | **Me banorët e qytetit**<br><br>**Salla e Kuvendit Komunal** | **Të gjithë anëtarët e KPF-së**<br><br>**Qeveria komunale** |
| **14.07.2023** | **10:00** | **Me biznese dhe fermerë** | **Lorik Maxhuni - kryesues**<br>**Ergin Sunguri**<br>**Isuf Jashari**<br>**Abit Abiti** |

**Melihate Basholli Latifi**

______________________________

**Kryesuese e KK-së dhe KPF-së**

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

*Sheshi "Ahmet Krasniqi"nr. 10 , Tel.038/200 42402, E-mail: ferit.idrizi@rks-gov.net*

| | |
|---|---|
| PËR/ZA/TO: | KPF dhe Kuvendin e Komunës |
| CC | |
| PËRMES/PREKO/THROUGH | Ferit Idrizi<br>Kryetar i Komunës |
| NGA/OD/FROM: | Komisioni:<br>Xhavit Mehmeti, Kryesues ____<br>Haki Maloku, anëtar ____<br>Ilirjana Azemi Igrishta ____<br>Bujar Klinaku, anëtar ____<br>Merita Rama Mulaku ____ |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Draft-Plani Komunal i Integritetit 2023-2025 |

---

Të nderuar/a anëtar/e të KPF dhe Kuvendit të Komunës,

Kryetari i Komunës ka themeluar komisionin për Draftim të Planit të Integritetit për periudhën 2023-2025 në përbërje: Xhavit Mehmeti kryesues, Haki Maloku anëtar, Ilirjana Azemi Igrishta anëtare, Bujar Klinaku anëtar dhe Merita Rama Mulaku anëtare.

Komisioni ka përgatitur Draft Planin e sipër cekur dhe ka zbatuar procedurat e konsultimit publik konform legjislacionit në fuqi. Gjatë diskutimit publik janë dhënë propozime dhe komente për plotësim të këtij plani të cilat janë inkorporuar në draftin final.

Në shtojcë gjeni të bashkëngjitur komentet gjatë diskutimit publik.

Draft-Plani i Integritetit me komente nga diskutimi publik ju dërgohet për shqyrtim dhe miratim.

Me respekt,

REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E VUSHTRRISË

DRAFT

# PLANI KOMUNAL PËR INTEGRITET

# 2023 - 2025

## KOMUNA E VUSHTRRISE

**Maj 2023**

Përmbajtje

Deklarata e Integritetit....3
Hyrja....4
PLANI PËR INTEGRITET....4
Parimet e menaxhimit të Integritetit....6
Lidershipi....6
Përfshirja e personelit....6
Qasja sistemore....6
Objektivat e Planit të Integritetit....6
Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit....7
Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit....7
Metodologjia e vlerësimit të rrezikut....8
Matrica e vlerësimit të rrezikut....8
Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut....9
Monitorimit i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi....9
Fushat e rrezikut....11
Fushat e përgjithshme të Rrezikut....11
Fushat specifike të rrezikut....11

DRAFT

## Deklarata e Integritetit

Kjo deklaratë ka për qëllim ofrimin e një deklarate gjithëpërfshirëse që pasqyron qartazi politikat, procedurat dhe masat tona operative përkitazi me integritetin, etikën, kulturën organizative, transparencën dhe llogaridhënien. Deklarata mbështetet në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale dhe aktet tjera komunale rregulluese.

Ky Plan i Integritetit synon të kontribuojë në ndërtimin e një administrate komunale profesionale dhe të modernizuar, të zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik lokal, me qëllim të ngritjes së mirëqenies së qytetarëve përmes ofrimit të shërbimeve efektive dhe cilësore për të gjithë.

Përmes Planit të Integritetit, do të promovohet demokracia lokale në mënyrë që komuna të përmbushë objektivat e saj për të përballuar sfidat ekonomike, sociale dhe politike.

Plani i Integritetit është gjithashtu i harmonizuar me obligimet strategjike, të përcaktuara nga Strategjia e Kosovës Kundër Korrupsionit dhe Plani i Veprimit Kundër Korrupsionit 2021-2023, në të cilat parashihet roli kyç i komunave në zhvillimin dhe implementimin e kornizës së integritetit.

Profesionalizmi, efikasiteti, efektshmëria, kultura organizative, llogaridhënia dhe transparenca në raport me qytetarët do të ndikojnë që të kthejmë integritetin dhe etikën në shtylla kyçe të sistemit tonë të menaxhimit.

Zotohemi që Komuna e Vushtrrisë me gjithë sinqeritetin dhe përkushtimin duhet të zhvillojmë më tej kapacitetet e Komunës dhe personelit tonë, për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive të gjitha sfidave që kanë të bëjnë me integritetin, si dhe për të menaxhuar në mënyrë adekuate rreziqet e shumta e të ndryshme të integritetit me të cilat ne ballafaqohemi.

Me plan të integritetit, ne do të zbatojmë në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse standarde, parimet dhe objektiva në parandalimin e korrupsionit dhe sjelljeve tjera të paligjshme dhe joprofesionale. Duke identifikuar rreziqet, planifikimin dhe zbatimin e masave adekuate, ne forcojmë integritetin dhe kulturën kundër-korrupsion në punën e organeve të administratës komunale. Përmes planit të integritetit, ne eliminojmë shkaqet e korrupsionit të cilat mundësojnë forcimin e sundimit të ligjit dhe besimin e qytetarëve.

Ne e kuptojmë se, që të jemi të suksesshëm, menaxhimi i rrezikut të integritetit nuk duhet të jetë një ushtrim i vetëm, por të jetë një proces i vazhdueshëm që përkrah zhvillimin dhe zbatimin e Planit të Integritetit. Andaj, jemi të përkushtuar që jo vetëm të zbatojmë masat e planifikuara, por edhe të bëjmë përpjekje për të integruar menaxhimin e rrezikut ndaj integritetit në kulturën organizative të Komunës në mënyrë të qëndrueshme. Të gjithë ne jemi përgjegjës për parandalimin efikas, zbulimin me kohë dhe hetimin e korrupsionit, mashtrimit apo çdo shkeljeje tjetër të integritetit në komunë.

Integriteti është zgjedhja, si individë, si organizatë dhe si institucion publik, që përfaqësojmë interesat e qytetarëve, që vazhdimisht t'i përmbahemi etikës dhe standardeve profesionale dhe të veprojmë sipas parimeve demokratike, ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Andaj, ne besojmë që ky plan i integritetit do të jetë një ndihmesë në luftën kundër korrupsionit, në krijimin e një kulture organizative të punës dhe respektimit të kodit etik, në mënyrë që qytetarëve t'u kthehet besimi në punën e Komunës së Vushtrrisë dhe shprehim gatishmërinë dhe përkushtimin e duhur për të gjitha përpjekjet për të fuqizuar dhe përmirësuar vazhdimisht sistemin e menaxhimit të integritetit brenda Komunës.

Ferit Idrizi – Kryetar i Komunës

## Hyrja

Në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe "Strategjinë Shtetërore Kundër Korrupsionit" të cilat obligojnë të gjitha institucionet të zhvillojnë dhe miratojnë planet e integritetit, Komuna e Vushtrrisë ka hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit për periudhën 2023 -2025.

Plani i integritetit është një mjet për vendosjen dhe verifikimin e integritetit të Komunës dhe është një proces i dokumentuar për të vlerësuar nivelin e cenueshmërisë së Komunës dhe ekspozimin e tyre ndaj praktikave jo etike dhe të korrupsionit. Plani është dokument operativ, që ofron masa të mbështetura tek rreziku për të arritur objektivat e integritetit të Komunës.

Plani rithekson përkushtimin e Komunës së Vushtrrisë për të shtuar dhe fuqizuar kontrollet ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet, duke u fokusuar në ofrimin e shërbimeve efikase, transparente dhe të orientuar kah qytetari. Plani përshkruan masat e bazuara në rrezik për arritjen e objektivave të Komunës dhe forcimin e sundimit të ligjit, si dhe vlerat dhe standardet profesionale.

## PLANI PËR INTEGRITET

Plani për Integritet është një dokument strategjik dhe operativ që konsiderohet si një mjet i rëndësishëm për fuqizimin e integritetit institucional. Ky plan kuptohet si një respektim i drejtpërdrejtë i vlerave morale, standardeve profesionale dhe i rregullave të zbatueshme normative. Gjithashtu, plani ofron masa të mbështetura tek rreziku për të arritur objektivat e integritetit të Komunës.

**Plani i integritetit mundëson:**

- Identifikimin e rreziqeve përkatëse të korrupsionit në fusha të ndryshme të punës në një Komunë;
- Vlerësimin e çfarëdolloj rreziku që mund të paraqes rrezik për shfaqjen e korrupsionit për një Komunë; dhe
- Përcaktimin e masave për të parandaluar ose eliminuar rreziqet e korrupsionit dhe sjelljeve tjera jo - profesionale.

**Plani i Integritetit do të kontribuojë në mënyrë domethënëse në:**

- ➢ Rritjen e mundësive që Komuna të arrijë objektivat e saj organizative, duke vënë përpara një menaxhim proaktiv të rrezikut të integritetit. Kjo do të përmirësoj rezistencën organizative ndaj korrupsionit dhe do të zvogëloj mundësitë për korrupsion;
- ➢ Përqendrimin tek prioritetet, në bazë të identifikimit dhe vlerësimit të rrezikut që do ta ndihmojnë Komunën të shpërndajë në mënyrë efektive burimet e disponueshme kundër korrupsionit, që të shfrytëzohen në mënyrën më mirë të mundshme;

- Përmirësimin e kontrolleve operacionale ndaj shkeljeve të integritetit që do të rrisin efektivitetin, efikasitetin dhe transparencën e të gjitha proceseve, përfshirë ofrimin e shërbimeve për qytetarët;

- Mbajtjen e një sistemi për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat dhe standardet ligjore dhe procedurale;

- Krijimin e një mjedisi të brendshëm të favorshëm kundër korrupsionit përmes trajnimit të synuar dhe ndërgjegjësimit, si dhe duke inkurajuar një bashkëpërgjegjësi të të gjithë stafit në procesin e zhvillimit, zbatimit dhe monitorimit të planeve të integritetit;

- Rritjen e besimit të punonjësve komunalë dhe palëve të jashtme të interesit në përkushtimin për integritet që demonstrohet nga Komuna.

Me zbatimin e këtij plani, Komuna do të vendoset më mirë për të siguruar një shpërndarje efektive, efikase, transparente dhe etike të rezultateve të synuara, përfshirë shërbime publike të përmirësuara të qytetarëve dhe grupeve të interesit. Gjithashtu, Komuna do të jetë në pozitë më të mirë për të siguruar efikasitet, efektivitet, transparencë dhe etikë gjatë arritjes së rezultateve të synuara, përfshirë këtu shërbimet më të mira për qytetarët dhe rritje të kënaqshmërisë nga ana e qytetarëve dhe grupeve të interesit.

Plani mbështetet në rezultatet e një planifikimi gjithëpërfshirës për integritetin dhe të një procesi të vlerësimit të rrezikut të bërë nga komuna. Procesi ka përfshirë identifikimin e pikave të dobëta të Komunës në rastet e shkeljeve të integritetit dhe vlerësimin e tyre duke marrë parasysh dëmet materiale dhe jo materiale që shkaktojnë shkeljet përkatëse potenciale dhe gjasat që ngjarje të tilla mund të ndodhin duke parë rezistencën aktuale organizative të vërtetuar në rregulloret, procedurat, kodet, praktikat dhe përfshirjen e punonjësve.

Plani mbështetet në rezultatet e një planifikimi gjithëpërfshirës për integritetin dhe të një procesi vlerësimi të rrezikut që Komuna e Vushtrrisë e ka bërë në periudhën 2023 - 2025. Procesi ka përfshirë identifikimin e pikave të dobëta të Komunës në rastet e shkeljeve të integritetit dhe vlerësimin e tyre duke marrë parasysh (1) dëmet materiale dhe jo - materiale që shkaktojnë shkeljet përkatëse potenciale dhe (2) gjasat që këto ngjarje të ndodhin prapë nga rezistenca aktuale organizative e vërtetuar nga rregulloret, procedurat, kodet, praktikat relevante dhe nga përfshirja e stafit.

## Parimet e menaxhimit të Integritetit

### Lidershipi

Menaxhmenti i lartë duhet në mënyrë të dukshme të demonstrojë një përkushtim aktiv të bazuar në fakte për integritetin. Kjo do të kërkonte nga ata që të udhëheqin procesin qysh nga fillimi, përmes zhvillimit të politikave të integritetit dhe Kodit të Etikës. Shumë e rëndësishme është që ky përkushtim të jetë i vazhdueshëm dhe që të kuptohet dhe të shihet mirë nga të gjithë stafi dhe palët interesit.

### Përfshirja e personelit

Pjesëmarrja e gjithë stafit është shumë e rëndësishme në zbatimin e suksesshëm të sistemit për menaxhimin e integritetit. Megjithatë, përfshirja kuptimplote kërkon edukimin e përshtatshëm dhe trajnimin lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me integritetin, ngritjen e vetëdijes, duke krijuar kështu besim dhe mjedis pozitiv për punë. Komunikimi efektiv i brendshëm dhe i jashtëm dhe koordinimi janë të rëndësishme për punë të suksesshme ekipore, në mënyrë që të gjitha palët e përfshira të marrin dhe të mbajnë të njëjtin kuptim për projektin derisa është duke u zbatuar.

### Qasja sistemore

Identifikimi i fushave potenciale të korrupsionit dhe menaxhimi i proceseve të ndërlidhura për të siguruar integritet kërkon qasje sistemore. Kjo kërkon nga Komunat që t'iu kushtojnë vëmendje të gjitha njësive dhe të analizojnë marrëdhënien dhe ndërvarësinë ndërmjet tyre. Një gjë e tillë arrihet brendapërbrenda grupit punues në Komunë.

## Objektivat e Planit të Integritetit

Objektivi kryesor i Planit të Integritetit është të rrisë dhe rendit përpjekjet dhe burimet për të parandaluar/eliminuar në mënyrë progresive dhe sistematike shkaqet dhe efektet shkatërruese të korrupsionit dhe të sjelljeve jo etike në Komunë.

Objektivat specifike janë:

- Sigurimi i një mekanizmi gjithëpërfshirës, ku të gjithë individët dhe njësitë në Komunë, si dhe qytetarët mund të përfshihen në luftën kundër korrupsionit dhe sjelljeve jo etike në punën e organeve të administratës komunale.

- Rritja e vetëdijesimit të qytetarëve mbi rreziqet e korrupsionit dhe të sensibilizojë qytetarët dhe bizneset për rolin e tyre në parandalimin/eliminimin e korrupsionit dhe sjelljeve jo etike.

- Përmirësimi dhe forcimi i mekanizmave të raportimit të rasteve të korrupsionit dhe sjelljeve jo etike në Komunë.

- Rritja e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve komunale.

- Krijimin dhe mirëmbajtjen e partneriteteve në luftën kundër korrupsionit dhe sjelljeve jo etike.

## Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit

Plani i Integritetit është një dokument që vlerëson integritetin e punës, integritetin institucional, pajtueshmërinë dhe mënyrën se si institucioni dhe punonjësit e tij veprojnë përmes vetëvlerësimit të ekspozimit ndaj rreziqeve, ndaj ndodhjes dhe zhvillimit të korrupsionit dhe/ose sjelljeve tjera të papranueshme etike dhe profesionale.

Plani i Integritetit kryesisht përbëhet nga:

- Regjistrimi i rreziqeve të identifikuara dhe të vlerësuara për të gjitha fushat e funksionimit të Komunës.
- Përcaktimi i masave për përmirësimin e integritetit që përshkruan në detaje të gjitha masat që duhet të zbatohen për të zvogëluar rreziqet e integritetit, si dhe afatin kohor përkatës dhe përgjegjësitë organizative për zbatimin e masave.

Me rastin e zhvillimit të Planit të Integritetit bëhet vlerësimi i rreziqeve të integritetit për të gjitha fushat e funksionimit të Komunës. I gjithë stafi komunal ka mundësi të marrë pjesë në vlerësimin e rrezikut të fushave të funksionimit të Komunës dhe të propozojnë masa për të përmirësuar integritetin dhe cilësinë e përgjithshme të menaxhimit si dhe ofrimin e shërbimeve.

### Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit

Zhvillimi i Planit të Integritetit përbëhet prej disa faza si në vijim:

- ***Faza përgatitore*** – Kryetari i Komunës themelon grupin e punues; përcakton strukturën e grupit punues dhe kryesuesin e tij, mund të delegojë një zyrtar për ta udhëhequr grupin; Kryetari emëron koordinatorin për zhvillimin e planit të integritetit; Grupi punues bënë mbledhjen e informacionit të nevojshme për zhvillimin e planit të integritetit si dhe njoftimi i të gjithë stafit për rëndësinë e Planit të Integritetit.
- ***Faza e vlerësimit të rrezikut të integritetit*** – gjatë kësaj faze koordinatori së bashku me grupin punues analizojnë dokumentacionin e mbledhur (legjislacionin dhe aktet nënligjore të zbatueshme në punën e administratës së Komunës; përshkrimet e vendit të punës dhe fushëveprimin e çdo njësie komunale) si dhe çdo proces për vendimmarrje dhe ofrimin e shërbimeve. Mbi bazën e analizës së gjendjes aktuale përcakton fushat e rrezikut dhe bënë identifikimi dhe vlerësimin e rreziqeve.
- ***Faza e përcaktimit të prioriteteve dhe propozimit të masave për përmirësimin e integritetit*** – kjo fazë përfshin përcaktimin e prioriteteve për intervenimin, përcaktimi i masave për parandalimin/eliminimin e rreziqeve dhe përgjegjësitë për zbatim.
- ***Faza e monitorimit dhe raportimit të planit të integritetit*** - përfshin monitorimin, vëzhgimin dhe regjistrimin e rregullt të aktiviteteve që ndodhin në një Plan të Integritetit dhe procesin e mbledhjes së informacionit për të gjitha aspektet e zbatimit të Planit të Integritetit. Ndërsa, raportimi mundëson që informacionet e mbledhura të përdoren në marrjen e vendimeve që përmirëson zbatimin e objektivave të Planit të Integritetit.

## Metodologjia e vlerësimit të rrezikut

Vlerësimi i rrezikut do të thotë renditja e rreziqeve më të mëdha në krye të listës, që paraqesin efekte thelbësore në integritetin e Komunës dhe mund të rrezikojnë efikasitetin, besueshmërinë dhe imazhin e jashtëm të Komunës. Kjo duhet të jetë baza për përcaktimin e masave për trajtimin e rrezikut. Prandaj, prioritetet përcaktohen ashtu që resurset e kufizuara në dispozicion për trajtim, mund të vendosen aty ku ndihet se janë më të nevojshme. Në përgjithësi, rreziqet e kategorizuara si të vogla, përputhen me standardet për marrje të rrezikut dhe nuk imponojnë nevojën për masa shtesë të trajtimit, por kërkojnë monitorim të efikasitetit të masave ekzistuese të trajtimit/kontrollit. Në anën tjetër, rreziqet madhore kërkojnë trajtim të menjëhershëm me masat adekuate.

Pas përcaktimit të dy parametrave, gjasave të ndodhjes së rrezikut dhe pasojave (ndikimit) të rrezikut të ndodhur, grupi punues duhet të përcaktojë nivelin e rrezikut për të gjitha rreziqet e identifikuara dhe të vlerësuara, duke përdorur Matricën e Rrezikut. Niveli përfundimtar i rrezikut përcaktohet bazuar në Matricën e Rrezikut si kombinim i gjasave dhe pasojave.

## Matrica vlerësimit të rrezikut

Matrica e vlerësimit të rrezikut mundëson të llogaritet rreziku në një fushë, aktivitet të Komunës për një kohë shumë të shpejtë, duke identifikuar të gjitha gjërat që mund të shkojnë keq dhe duke përshkruar dëmin e mundshëm. Kjo e bën më të lehtë prioritizimin e çështjeve dhe ndërmarrjen e veprimeve dhe masave aty ku është më e nevojshme për të mbajtur fushën, aktivitetin e Komunës në rrugë të mbarë.

Figura 1 . Matrica e vlerësimit të rrezikut




Intensiteti i rrezikut fitohet duke shumëzuar probabilitetin/gjasën me pasojën/ndikimin, duke përdorur matricën e rrezikut, "ndikimi (1-10) x gjasat (1-10)", treguar në figurën si më lartë.

## Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut

Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut të korrupsionit dhe formave të tjera të dëmtimit të integritetit, vlerësohet nga 1 në 100, si në tabelën e më poshtme:

| Ulët | Mesatar | Lartë |
|---|---|---|
| 1 – 15 pikë | 16 - 48 | 49 - 100 |

Rreziku me intensitet të ulët – mundësia e ndodhjes së korrupsionit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është shumë e vogël për shkak të masave ekzistuese të kontrollit.

Rreziku me intensitet të mesëm – ndodhja e korrupsionit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është e mundur, por masat e kontrollit menaxhojnë këtë rrezik.

Rreziku me intensitet të lartë – Korrupsioni ose format e tjera të dëmtimit të integritetit janë tashmë të pranishëm në këtë proces ose ka të ngjarë të ndodhin.

# Monitorimit i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi

Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në vazhdimësi me mekanizma përkatës, do të rishikohet periodikisht dhe do të azhurnohet në përputhje me zhvillimet relevante normative, institucionale, procedurale dhe të personelit brenda mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm të Komunës. Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se kontrolli i rrezikut të integritetit dhe masat për trajtim janë efektive, si në projektim ashtu edhe në funksionim, dhe se procedurat janë kuptuar, si dhe plani integriteti është ndjekur.

Gjithashtu, monitorimi duhet të përcaktojë nëse masat e përdorura për trajtimin e rrezikut të integritetit kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë zbuluar ndryshimet në kontekstin e jashtëm dhe të brendshëm përfshirë ndryshimet e vetë rrezikut, ndryshime që kërkojnë rishikimin e trajtimit dhe prioriteteve të rrezikut si dhe kanë identifikuar cilat mësime duhen nxjerrë për planifikim në të ardhmen.

Raportimi i rregullt siguron se zbatimi i Planit bëhet në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planifikuara janë arritur. Gjithashtu, pas hartimit të raportit për zbatimin e planit të integritetit, raporti duhet të dërgohet për diskutim në Kuvendin Komunal.

Me qëllim të sigurimit të zbatimit të planit të integritetit krijohen mekanizmat për monitorimin dhe raportimin për zbatimin e Planit të Integritetit, si në vijim:

1. ***Grupi punues*** - emërohet me vendim të Kryetarit të Komunës dhe është përgjegjës për:

- promovimin e integritetit në Komunë dhe merr masa për të parandaluar korrupsionin, konfliktin e interesit dhe format e tjera të sjelljeve jo etike;

- hartimin e draftit të Planit Komunal të Integritetit;

- përgatitjen e programit për hartimin e planit të integritetit;

- siguron që Plani i Integritetit të jetë në pajtim me legjislacionin në fuqi, standardet e punës, metodat e vlerësimit të integritetit dhe me metodat e riparimit;

- zhvillimin e një qasje sistematike, gjithëpërfshirëse dhe të integruar ndaj rreziqeve;

- propozimin e masave të nevojshme për eliminimin dhe parandalimin e korrupsionit, konfliktit të interesit dhe formave tjera të sjelljeve jo etike;

Grupi punues mbaron mandatin pas hartimit të planit komunal për integritet. Kryetari i Komunës themelon grupin e ri punues varësisht nga vlerësimi i nevojave.

2. ***Koordinatori për integritet*** - emërohet me vendim të Kryetarit të Komunës dhe është përgjegjës për:

- përgatitur metodologjinë për monitorimin e Planit të Integritetit;

- raportimin mbi zbatimin e Planit të Integritetit;

- të mbledhë dhe analizon dokumentacionin e nevojshëm në lidhje me funksionimin e organeve të Komunës, i cili është baza për vlerësimin e rrezikut dhe zhvillimin e Planit të Integritetit;

- pranimin dhe rishikimin e informacionit për situatat, ndodhitë dhe veprimet për të cilat ekziston një besim i arsyeshëm se ato përfaqësojnë një mundësi për shfaqjen dhe zhvillimin e korrupsionit, konfliktit të interesit dhe formave tjera të sjelljeve jo etike;

- përgatitë dhe shpërndan pyetësorin si dhe zhvillon intervistat me stafin komunal, me qëllim të mbledhjes së informatave për hartimin e Planit të Integritetit;

- në bashkëpunim me të gjitha njësitë organizative, përgatit raportet për zbatimin e planit të integritetit;

- sigurimin e zbatimit, azhurnimit dhe vlerësimit në bazë të vazhdueshëm të Planit të Integritetit si dhe standardet, format dhe procedurat për të mbështetur Planit të Integritetit;

- harton raporte periodike për monitorimin e planit të integritetit dhe i raporton kryetarit.

Koordinatori, gjithashtu, mbështet grupin punues në hartimin dhe përgatitjen e raporteve për zbatimin e Planit të Integritetit. Koordinatori i rekomandon Kryetarit për takim me grupin punues sa herë që vlerësohet e nevojshme.

# Fushat e rrezikut

## Fushat e përgjithshme të Rrezikut

1. Udhëheqja dhe menaxhimi;
2. Politika e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve;
3. Planifikimi dhe Menaxhimi i Buxhetit dhe Financave;
4. Ruajtja dhe siguria e të dhënave dhe dokumenteve;
5. Plani Komunal për Pjesëmarrje Qytetare

## Fushat specifike të rrezikut[1]

1. Auditimi i Brendshëm;
2. Prokurimi publik;
3. Menaxhimi i kontratave publike;
4. Zhvillimi ekonomik lokal dhe bujqësia;
5. Planifikimi urban dhe rural;
6. Standardet e ndërtimit dhe kontrolli;
7. Inspektimet;
8. Arsimi Publik;
9. Shëndeti publik;
10. Menaxhimi i pronës së paluajtshme komunale;
11. Parandalimi i konfliktit të interesit për zyrtarët komunal;
12. Subvencionet komunale.

[1] Fushat specifike mund të ndryshojnë varësisht nga specifikat e Komunave.

DRAFT

| FUSHAT E PËRGJITHSHME TË RREZIKUT | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Regjistrimi i rrezikut** | | | **Vlerësimi dhe matja e rrezikut** | | | | **Veprimi ndaj rrezikut** | | |
| **Nr.** | **Fusha e rrezikut** | **Përshkrimi i Rreziku** | **Masat ekzistuese të kontrollit** | **Gjasat** | **Ndikimi** | **Vlerësimi i rrezikut** | **Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve** | **Njësia/zyrtari përgjegjës** | **Afati i realizimit** |
| 1. | **UDHËHEQJA DHE MENAXHIMI** | Objektivat dhe prioritetet e zhvillimit të komunës të paqarta dhe jo transparente | Ligjet dhe aktet nënligjore; Raportet periodike; aktet e brendshme të komunës, Plani i Integritetit | 6 | [redacted] | [redacted] | Hartimi i Planit Zhvillimor. (Ligji për Planfikim Hapësinor) | Kuvendi dhe Kryetari i Komunës, drejtoritë komunale dhe njësitë përgjegjëse | Qershor 2023 – Qershor 2024 |
| | | | | | | | Përfshirja e të gjithë akterëve (komuniteti i biznesit, fokus grupeve, shoqëria civile dhe qytetarët) në zhvillimin e Planit Zhvillimor të komunës | | |
| | | Mospërfshirja e të gjitha fushave përkatëse në Planin Zhvillimor. | | | | | Plani i konsultimeve publike në hartimin e Planit Zhvillimor | Kuvendi dhe Kryetari i Komunës, drejtoritë komunale dhe njësitë përgjegjëse | Në vazhdimësi |
| | | Opinion publik me përcepcion negativ dhe humbja e besimit të publikut në punën e administratës | | 4 | [redacted] | 32 | Informimi dhe komunikimi me qytetarët përmes mjeteve të ndryshme të komunikimit (Ueb faqja e komunës, rrjetet sociale, | Kryetari i Komunës, Zyra për Komunikim me Publikun, Drejtorët e drejtorive | Në vazhdimësi |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | komunale dhe Kuvendit Komunal për shkak të transparencës të pamjaftueshme | | | | | takimet e drejtpërdrejta me qytetarët) | | |
| | | | | | | | Përfshirja e shoqërisë civile në hartimin dhe konsultimin e politikave publike në procesin e vendimmarrjes. | Kryetari i komunës, Drejtorët e drejtorive | Në vazhdimësi |
| | | Mospërputhja dhe paqartësia e përgjegjësive në administratën komunale | | 5 | 8 | 40 | Rishikimi i organizimit të brendshëm të administratës përmes Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës. | Kryetari i komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, Drejtorët e drejtorive, udhëheqësit e sektorëve | Dhjetor 2023 |
| | | Mos monitorimi dhe raportimi mbi zbatimin e Planit të Integritetit | | 3 | 9 | 27 | Hartimi i planit të monitorimit dhe zbatimit te planit te integritetit | Kuvendi i komunës, Kryetari i komunës, Agjencia kundër korrupsionit | Një herë në vit dhe sipas nevojave/kërkesave |
| | | | | | | | Të rishikohet niveli i zbatimit dhe përditësohen masat për përmirësime. | Menaxheri i integritetit, Koordinatori dhe Grupi Punues i integritetit . | Çdo gjashtë muaj |
| 2. | **POLITIKA E BURIMEVE NJERËZORE, SJELLJA ETIKE DHE PROFESIONALE E TË PUNËSUARVE** | Mosplotësimi i vendeve të punës me staf adekuatë dhe të mjaftueshëm | Ligjet, aktet nënligjore; dhe aktet e brendshme të komunës | 5 | 8 | 40 | Zhvillimi dhe miratimi i Planit të Personelit | Kryetari i komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtorët e drejtorive | Dhjetor të çdo viti |
| | | Mungesa e kapaciteteve profesionale të të punësuarit. | | 5 | 8 | 40 | Hartimi i planit të vlerësimit vjetor te zyrtareve komunal. | Kryetari i komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtorët e drejtorive | Në vazhdimësi |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | Analizimi i nevojave për trajnime | Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtorët e drejtorive | |
| | | | | | | | Trajnimi i vazhdueshëm i të punësuarve në të gjitha drejtoritë/njësitë | | |
| | | | | | | | Hartimi i një analize për ndikimin e trajnimeve | | |
| | | Përshkrimet e vendeve të punës të nëpunësve të pa qarta, jo adekuate. | | 4 | 7 | 28 | Të bëhet rishikimi i detyrave të punës si dhe harmonizimi i tyre me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës. | Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtorët e drejtorive dhe udhëheqësit e sektorëve. | Në vazhdimësi |
| | | | | | | | Harmonizimi i përshkrimit të vendeve te punës. | Kryetari i komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtorët e drejtorive | Në vazhdimësi |
| | | Mungesa e kodit komunal të etikës për gjithë zyrtarët komunal përfshirë zyrtarët publik dhe të zgjedhurit dhe të emëruarit. | | 7 | 10 | 70 | Hartimi dhe miratimi i Kodit të Etikës për gjithë zyrtarët komunal përfshirë zyrtarët publik dhe të zgjedhurit dhe të emëruarit | Kryetari i komunës dhe Kuvendit, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtorët e drejtorive dhe udhëheqësit e sektorëve | Në vazhdimësi |
| | | Mungesa e informimit dhe sensibilizimit për ekzistencën e kodit të etikës për stafin drejtues dhe stafin tjetër të komunës | | 4 | 7 | 28 | Shpërndarja e Kodit të Etikës për të gjithë zyrtaret komunal dhe organizimi i takimeve për informim me përmbajtjen e Kodit. | Kryetari i komunës dhe i Kuvendit, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtorët e drejtorive dhe udhëheqësit e sektorëve | Në vazhdimësi |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Niveli i pamjaftueshëm i ndërgjegjësimit të punonjësve për raportimin e korrupsionit dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme brenda institucionit. | | 5 | [redacted] | 40 | Mbajtja e takimeve të rregullta ndërmjet menaxhmentit dhe personelit për prezantimin dhe diskutimin për mekanizmat e raportimit të korrupsionit dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme. | Kryetari i komunës, drejtorët e drejtorive, koordinatori i planit të integritetit dhe sinjalizuesi | Në vazhdimësi |
| 3. | **PLANIFIKIMI DHE MENAXHIMI I BUXHETIT DHE FINANCAVE** | Planifikimi jo adekuat i buxhetit vjetor komunal. | Ligjet, aktet nënligjore; KAB, dhe aktet e brendshme të komunës | 6 | [redacted] | 42 | Organizimi i trajnimeve dhe punëtorive për planifikim dhe shpenzim të buxhetit | Drejtoria për Buxhet dhe Financa | TM2 – TM3 i vitit fiskal |
| | | | | | | | Përfshirja e të gjitha palëve relevante gjatë planifikimit të buxhetit; | Kuvendi/KPF, Kryetari i komunës; zyrtari kryesor financiar | TM2 – TM3 i vitit fiskal |
| | | Mosmiratimi me kohë i buxhetit | | 5 | [redacted] | [redacted] | Planifikimi dhe aprovimi i buxhetit sipas KAB-it dhe Qarkoreve buxhetore | Kuvendi/KPF, Kryetari i komunës dhe drejtorët e drejtorive | 30 shtator i çdo viti |
| | | Shpenzimi i buxhetit jo në mënyrë adekuate dhe jo mjaftueshëm transparent | | 7 | [redacted] | [redacted] | Planifikimi i saktë i shpenzimeve | Njësitë buxhetore | Pas aprovimit të buxhetit vjetor |
| | | | | | | | Raportim i rregullt për shpenzimet buxhetore. | Drejtoria për Buxhet dhe Financa/ZKF | Në vazhdimësi |
| | | | | | | | Publikimi i shpenzimeve në ueb faqen e komunës | Drejtoria për Buxhet dhe Financa/ZKF<br>Zyra për Komunikim me Publikun | Çdo tremujor |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | Raportim i rregullt për shpenzimet buxhetore dhe realizimin e buxhetit | Drejtoria për Buxhet dhe Financa/ZKF | Në vazhdimësi |
| | | Mos regjistrimi ne E-pasuri | | 5 | 10 | 50 | Funksionalizimi i depos /depoist | Drejtoria e Administrates, Drejtoria për Buxhet dhe Financa | Gjashtëmujor |
| | | Inventarizimi dhe regjistrimi joefikas i pasurisë jo financiare | | 6 | 9 | 54 | Përditsimi i regjistrit i brendshëm i aseteve të komunës | Drejtoria për Buxhet dhe Financa | Në vazhdimësi |
| 4. | **RUAJTJA DHE SIGURIA E TË DHËNAVE DHE DOKUMENTEVE** | Siguria e pamjaftueshme e të dhënave në sistemet e teknologjisë informative si dhe përdorimi i tyre për qëllime jozyrtare | Ligjet, aktet nënligjore; dhe aktet e brendshme të komunës. | 4 | 9 | 36 | Zhvillimi dhe miratimi i procedurës së punës për proceset që realizohen përmes sistemeve të teknologjisë informative | Kryetari i komunës, Drejtoria e Administratës dhe sektori i TIK-ut | TM1 2024 |
| | | | | | | | Informimi itë gjithë të punësuarit lidhur me rreziqet nga mashtrimet dhe korrupsioni që kanë të bëjnë me sigurinë e informacionit dhe shfrytëzimin e të dhënave të kompjuterizuara | Drejtoria e Administratës dhe sektori i TIK-ut | Në vazhdimësi |
| | | Trajtimi jo adekuat i dokumentacionit zyrtar dhe informacionit | | 3 | 8 | 24 | Zhvillimi dhe miratimi i procedurës së brendshme mbi trajtimin e dokumentacionit dhe informacionit zyrtar | Kryetari i komunës, Drejtoria e Administratës | Tremujori i katërt 2023<br>2023 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | |
| 5. | **PLANI KOMUNAL PËR PJESËMARRJE QYTETARE** | Moszbatimi i planit komunal | Ligjet, aktet nënligjore; dhe aktet tjera, duke përfshirë Planin komunal për pjesëmarrje qytetare | 5 | 8 | 40 | Transparenca e punës së kuvendit komunal | Kryesuesi/sja e kuvendit, sekretaria e kuvendit, Zyra për Komunikim me Publikun | Në vazhdimësi |
| | | Mosmbajtja e konsultimeve publike | | | | | Plani vjetor i konsultimeve publike | Kryetari i komunës, Drejtoritë, Zyra për Komunikim me Publikun | TM1 i çdo viti |
Me anë të kësaj shkrese i drejtohem titujve të lartë përmendur që të marrin vendim për subvencionimin e botimit të librit ,,Rrezet e Lirisë" nën patronatin e Komunës së Vushtrrisë i cili iu kushtohet 75 dëshmorëve të kombit të zonë së veprimit të Brigadës 142 të ZO të Shalës.

Libri u hartua pas një pune 3 vjeçare duke mbledhur shënime nga bashkëluftëtarët dhe familjarët e dëshmorëve dhe në bazë të njohurive të mija si eprorë i një pjese të tyre. Në libër janë përfshirë 36 dëshmor nga Vushtrria, 33 dëshmor, nga Mitrovica dhe 6 dëshmor nga Kastrioti. .Libri përmes 860 faqeve me 511 fotografi, përshkruan jetën, veprën dhe heroizmin e dëshmorëve të kombit të zonës së veprimit të Brigadës 142, gjatë luftës deri në rënien e tyre në altarin e lirisë për çlirimin e vendit.

Në kapitujt e parë të librit është bërë një vështrim i shkurtër i historisë së Zonës Operative të Shalës dhe të Zonës së veprimit të Brigadës 142 të ZO të Shalës.

Pastaj në libër është bërë përllogaritja e forcës së gjallë dhe të armatimit të forcave ushtarake të armikut të cilat kanë qenë të angazhuara gjatë luftës në Kosovë.

Duke u nisur nga rëndësia që ka ky libër për promovimin e luftës së lavdishme të UÇK-ës dhe të dëshmorëve e heronjve të saj nga Zona e veprimit të Brigadës 142 të ZO të Shalës, kërkojmë përkrahje financiare të subvencionit të këtij librit nga organet e lartë cekura komunale në shumë minimale prej 7,000 euro për botimin e 350 kopjeve të librit. Kësaj shume duhet shtuar edhe shpenzimet e domosdoshme për ekipin e botim në shumat sipas specifikimit: Kopërtina, dizajni dhe thyerja teknike 2 x 150 = 300 euro, redaktuara 200 euro, recensuesit 2 x 150 = 300 euro, lektura 200 euro , rezymeja anglisht 100 euro e të cilat bëjnë gjithsejtë 1,100 euro dhe shtypshkronja 7,000, gjithsejtë shpenzimet për botimin e librit = 8,100 euro.

Shpresojmë që kërkesa e jonë do të hasë në mirëkuptimin nga Kryetari i Komunës dhe Asambleja e Kuvendit Komunal të Vushtrrisë për ndarjen e shumës së subvencionit të kërkuar për botimit të librit. Bashkangjitur kërkesës keni dukjen e kopertinën dhe përmbajtjen e librit. Nëse ka nevojë mund tua sjellim edhe një kopje elektronike të librit.

Vushtrri, maj, 2023

Me respekt
Gani Lahu , ish Komandant i
Batalionit të Dytë të Brigadës 142 të ZO të Shalës

GANI N. LAHU

# RREZET E LIRISË

**Dëshmorët E Kombit Të Zonës Së Veprimit të Brigadës 142 Të Zonës Operative të Shalës**

Vushtrri, 2022

# Përmbajtja

Hyrje..........21
**Kapitulli i parë**
1. Nëpër rrjedhat e historisë tonë kombëtare..........25
1.1 Vështrim i shkurtër i historisë mbrojtëse të ZO të Shalës..........25
1.2 Lashtësia e trojeve të Mitrovicës dhe Vushtrrisë..........25
1.3 Dyndjet e popujve barbarë në Gadishullin Ilirik..........26
1.4 Depërtimi i sllavëve në Dardani..........26
1.5 Pushtimi i trojeve shqiptare nga Perandoria otomane..........27
1.6 Konvertimi i shqiptarëve në serbë, grekë, malazezë, maqedon e turq..........28
1.7 Marrëveshja e Shën Stefanit dhe Kongresi i Berlinit i vitit 1878..........40
1.8 Veprimtaria e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për kundërshtimin e Traktatit të Shën Stefanit dhe të Kongresit të Berlinit..........41
1.9 Pushtimi serb i trojeve shqiptare..........46
1.10 Dëbimi i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit..........47
1.11 Kryengritja për çlirim të vendit, e viteve 1908-1912..........47
1.12 Lufta e Parë Ballkanike dhe pushtimi i Kosovës nga Serbia..........50
1.13 Kundërshtimi i pushtetit okupues serbo-jugosllav..........51
1.14 Pushtimi i Kosovës nga Austrohungaria..........52
1.15 Ripushtimi i Kosovës nga mbretëria jugosllave..........53
1.16 Veprimtaria kombëtare e organizatave politike nën pushtimin e mbretërisë jugosllave..........54
1.17 Aktiviteti i Komitetit – Mbrojtja Kombëtare e Kosovës..........54
1.18 Partia politike "Bashkimi" – Xhemiet..........56
**Kapitulli i dytë**
2. Veprimtaria kundër pushtetit nazist gjerman 1941-1945..........59
2.1 Caktimi i kufirit shqiptaro-serb në lumin Ibër..........59
2.2 Aksioni i Mehmet Gradicës, më 8 prill 1941 për lirimin e të burgosurve në Vushtrri..........60
2.3 Organizimi ushtarak për mbrojtjen e Drenicës dhe Artakollit në vitin 1941..........62
2.4 Luftimet e Artakollit me njësitë diversante të Serbisë në vitin 1941..........66
2.5 Mbrojtja e Artakollit nga sulmi i ushtrisë serbe, më 10 prill 1941..........70
2.6 Formimi i forcave të armatosura për mbrojtjen e Kosovës..........74
2.7 Mbrojtja e kufijve verior të vendit..........75
2.8 Aradhat partizane të Kosovës..........77
2.9 Rezistenca e Kosovës kundër njësive partizan të Jugosllavisë..........77

**Kapitulli i tretë**

3. Organizimi i mbrojtjes kundër regjimit ushtarak jugosllav........................85
3.1 Luftimet e Brigadave shqiptare në Shalë gjatë dimrit të vitit 1944............86
3.2 Qëndresa e Adem Vocës në luftë me forcat çetniko-partizane....................87
3.3 Shtabi i Brigadës së Shaban Palluzhës refuzon shkuarjen në frontin e Sremit........................................................................89
3.4 Luftimet e Brigadës së Shaban Palluzhës në vitin 1945 me ushtrinë çetniko-partizane në fshatrat e Artakollit...................................92

**Kapitulli i katërt**

4. Terrori i pushtetit komunistë në Vushtrri..................................................97
4.1 Protestat e grave të Vushtrrisë kundër krimeve të OZN-ës jugosllave..........................................................................99
4.2 Kooperativa e rrobaqepësisë në Vushtrri.............................................101
4.3 Pozita kushtetuese e Kosovës në ish-Jugosllavi....................................102
4.4 Avancimi i të drejtave të Kosovës me Kushtetutën e vitit 1974..............103
4.5 Suprimimi i Autonomisë së Kosovës nga Serbia....................................104

**Kapitulli i pestë**

5. Veprimtaria e organizatave ilegale në territorin e Vushtrrisë......................109
5.1 Organizata Nacional Demokratike Shqiptare – ONDSH në Vushtrri.................................................................110
5.2 Lëvizja për Çlirim dhe Bashkim Kombëtar............................................112
5.3 Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve..............................113
5.4 Organizimi i demonstratave të vitit 1968...............................................115
5.5 Bojkotimi i mësimit në shkollat e mesme në Vushtrri............................115
5.6 Lëvizja Nacional Çlirimtare e Kosovës dhe Viseve Shqiptare në Jugosllavi.......................................................................116
5.7 Organizata Marksiste Leniniste e Kosovës...........................................117
5.8 Partia Komuniste Marksiste Leniniste Shqiptare në Jugosllavi (PKMLSHJ)...........................................................................118

**Kapitulli i gjashtë**

6. Fillimi i luftës në ish-Jugosllavi dhe përgatitjet për rezistencë të armatosur në Kosovë.......................................................121
6.1 Obligimet kushtetuese për mbrojtjen e vendit.......................................122
6.2 Themelimi i Frontit Nacional Çlirimtar të Popullit Shqiptar në Jugosllavi (FNÇPSHJ) -- Organizatë politiko-ushtarake për mbrojtjen dhe çlirimin e vendit..............................................................126
6.3 Këshilli komunal i mbrojtjes popullore...............................................127
6.4 Këshilli i vendit për mbrojtje popullore...............................................128
6.5 Këshilli koordinues i bashkësisë së fshatrave......................................128
6.6 Sektorët e mbrojtjes popullore...........................................................129
6.7 Mënyra e punës e këshillave të mbrojtjes popullore...............................129
6.8 Veprimtaria e Këshillit komunal për mbrojtje popullore...........................130

6.9 Veprimtaria e Sektorit për mbrojte territoriale....131
6.10 Ushtrimet fushore të njësive territoriale....132
6.11 Veprimtaria e Sektorit të mbrojtjes shëndetësore....135
6.12 Veprimtaria e Sektorit të furnizimit dhe financimit....136
6.13 Veprimtaria e Sektorit për evakuim dhe strehim të popullatës....137
6.14 Veprimtaria e Sektorit për informim dhe lajmërim....138
6.15 Aktivitetet e këshillave vendore të mbrojtjes....138
6.16 Pengimi i veprimtarisë së FNÇPSHJ-ës nga ana e strukturave të LDK-ës....140
**Kapitulli i shtatë**
7. Veprimtaria e partive politike në vitet e 90-ta në Komunën e Vushtrrisë....143
7.1 Aktivitetet e degës së LDK-ës në Vushtrri....146
7.2 Komisioni për ndihma solidare....148
7.3 Aksioni i solidaritetit – Familja ndihmon familjen....149
7.4 Regjistrimi i popullsisë së Vushtrrisë....151
7.5 Aktivitetet e Komisioneve, Shoqatave, Këshillave dhe organeve tjera shtetërore....152
**Kapitulli i tetë**
8. Dalja në skenë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës....155
8.1 Zonat ushtarake....156
8.2 Përcaktimi i zonës operative ushtarake....156
8.3 Formimi i zonave ushtarake në Kosovë....157
8.4 Zona Operative e Shalës....158
8.5 Organizimi i UÇK-ës nën Zonën Operative të Qyçavicës – në Zonën Operative të Shalës....162
8.6 Themelimi i qendrës shkolllore për aftësimin ushtarak të pjesëtarëve të UÇK-ës në fshatin Trimor ish-Zhilivodë....166
**Kapitulli i nëntë**
9. Forcat ushtarake jugosllave të angazhuara në Kosovë gjatë luftimeve të viteve 1998-1999....171
9.1 Korpusi i Prishtinës....171
9.2 Zona e veprimit të Korpusit të Prishtinës....173
9.3 Angazhimi i ushtrisë në mbështetje të aksioneve të policisë....174
9.4 Përgatitjet e Korpusit të Prishtinës për luftë në vitin 1999....177
9.5 Llogaritja e forcave jugosllave të angazhuara në luftimet e Kosovës....180
9.6 Llogaritja e forcave ushtarake të angazhuara në Kosovë sipas dëshmive të Kryetarit të RFJ-ës Sllobodan Milloshevic....182
9.7 ZO e Shalës në ballafaqim me njësitë ushtarake e policore jugosllave....188
9.8 Potenciali ushtarak i forcave jugosllave, i përdorur në luftimet e Kosovës....190

9.9 Brigada e 37-të e motorizuar......190
9.10 Brigada e 15-të e blinduar......193
9.11 Mbrojtja e prapavisë e njësive ushtarake operative......195
9.12 Brigada e 252-të e blinduar......197
9.13 Brigada e 52-të e artilerisë raketore, e mbrojtës kundërajrore......198
9.14 Brigada e 243-të e mekanizuar, e vendosur në
Kazermën e Ferizajt......199
9.15 Brigada e 211-të e blinduar......200
9.16 Brigada e 58-të e këmbësorisë së lehtë......201
9.17 Brigada e 7-të e këmbësorisë......202
9.18 Brigada e 354-të e këmbësorisë......203
9.19 Brigada e 125-të e motorizuar......204
9.20 Brigada e 63-të parashutiste......204
9.21 Brigada e 549-të e motorizuar......205
9.22 Brigada e 57-të e këmbësorisë e Korpusit të Podgoricës......206
9.23 Brigada speciale e 72-të e Jugosllavisë......207
9.24 Batalioni i 52-të i policisë ushtarake i Korpusit të Prishtinës......207
9.25 Batolini i 287-të i policisë ushtarake i Korpusit të Nishit......208
9.26 Përmbledhje e potencialit ushtarak të angazhuar gjatë luftimeve......208
9.27 Luftimet në rrugët e Mitrovicës......209
**Kapitulli i dhjetë**
10. Biografitë e dëshmorëve të kombit të zonës së
përgjegjësisë, të Brigadës 142 të ZO të Shalës......215
1. Artim Jashari......225
2. Ramadan Fazli......237
3. Qamil Zeqiri......244
4. Naim Osmani......250
5. Faik Mjeku......256
6. Jeton Tërstena......265
7. Bastri Beqiri......273
8. Avni Saraçi......281
9. Avni Dibrani......288
10. Sadullah Dibrani......295
11. Salih Sejdiu......300
12. Mustafë Shyti......307
13. Bislim Imeri......326
14. Hamit Hyseni......331
15. Agim Ramadani......336
16. Ismet Haliti......342
17. Xajë Jashari......346
18. Nezir Imeri......352
19. Hamdi Hajrizi......358

20. Bektesh Haliti.....371
21. Selman Miftari.....380
22. Sami Gashi.....384
23. Afrim Hajrizi.....392
24. Mehdi Haziri.....399
25. Gazmend Baliu.....408
26. Muhamet Gashi.....415
27. Bahri Kuçi.....423
28. Sabedin Prekazi.....434
29. Agim Islami.....439
30. Shaban Krasniqi.....449
31. Jashar Jashari.....456
32. Mehdi Zabeli.....471
33. Blerim Saraçi.....482
34. Harun Beka.....493
35. Sylejman Kalludra.....500
36. Gëzim Rama.....503
37. Ekrem Jusufi.....511
38. Enver Tahiri.....518
39. Avni Klinaku.....525
40. Januz Jashari.....532
41. Murat Krasniqi.....540
42. Fadil Deliqi.....544
43. Driton Veliu.....550
44. Blerim Durmishi.....556
45. Remzi Durmishi.....560
46. Kadri Dushi.....565
47. Lutfi Krasniqi.....576
48. Afrim Krasniqi.....580
49. Agron Gashi.....584
50. Tafil Osmani.....588
51. Besim Nuka.....593
52. Hamdi Krasniqi.....599
53. Skënder Skënderi.....605
54. Blerim Zuçaku.....611
55. Hamdi Sheremeti.....617
56. Mehdi Hajredini.....621
57. Ramadan Peci.....625
58. Bekim Doroci.....632
59. Zeqir Rexhepi.....637
60. Adnan Shyti.....641
61. Shahin Syla.....648

62. Shaip Kalludra....................654
63. Shaban Shabani....................659
64. Safet Rexhepi....................664
65. Gani Hajra....................669
66. Safet Ajeti....................672
67. Fadil Franca....................677
68. Esat Imeri....................681
69. Sheqir Avdiu....................688
70. Nuhi Kelmendi....................694
71. Ferki Aliu....................702
72. Avni Hajredini....................708
73. Halit Salihu....................716
74. Musa Hajrizi....................725
75. Amrush Klinaku....................732
11. Përfundim....................737
12. Conclusion....................753
13. Foto Albumi....................769
14. Dokumente....................803
15. Literatura....................849
16. Biografia e autorit....................859

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI - OPŠTINA VUČITRN - MUNICIPALITY OF VUSHTRRI

# Formulari per kerkese apo ankese

**Drejtorati/Njesia** Kuvendi i Komunës

**Data** 11/05/2023

Mos shkruani në këtë pjesë

**Numri i protokolit** 01-104/02-0020317/23

**Afati i zgjedhjes** 10/06/2023

**Vendimi**

**1.Informatat personale te parashtruesit te kerkeses:**

**Emri dhe mbiemri** Shoqata e te burgoseve politik Vushtrri

**Numri personal** /

**Adresa e vendbanimit** /

**E-mail Adresa**

**Numri i tel. fiks**

**Numri i tel. mobil** 45959444

**Vlera për pagesë:** 0.00

**2. Mënyra e pranimit** Kërkesa

**Statusi i lëndës** Ne proces

**3. Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:**

kerkes

**4. Dokumentet e bashkangjitura:**

**Nr.** **Lloji i dokumentit**

**5. Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi**

UnëShoqata e te burgoseve politik Vushtrri vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta.

(Nënshkrimi)

*Ju lutemi të kërkoni nga zyrtari/ja fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkese dhe dokumenteve të bashkangjitura

**Pranuar nga:** sabri.xhaferi

SHOQATA E TË BURGOSURVE POLITIK E KOSOVËS
ASSOCIATION OF POLITICAL PRISONERS OF KOSOVA

DEGA; VUSHTRRI

Nr821/23,
Datë 11.05.2023..

Logaria bankare: TEB 2016000089163645 Vushtrri
Tel- 045 959 444.

Lënda:Kerkese
Per rishqyrtimin e ndarjen e sumvezonev
Per SHBP dega Vushtrri.

KUVENDIT KOMUNAL
VUSHTRRI

Enderuara Z. Kryetare, dhe antar.kuvendi

Siq e dini SHBPK fungsionon duke e mbshtet ne ndihemen e juaje, qe na ofroni Megjithat nje ndihme e till na nevoitet të vazhdojme punën e shoqates. Meqense bejme grumbullimin e dokumentave të denuarve politik, dhe mbajme evidenca në menyr kontuele bëjmë edhe përshkrimin e tyre si dhe paisjen me dokumentacione të ndryshme si psh: kopjimin e tyre, dhe sistemimin, etj. Shoqata deri me tani ka në evidencen e vet 586 antarë.Bejm edhe arkivimin e dukumentev me ransi.

Nevoe për shoqaten e SHBPK të cilen e perfaqesojë, parashihen edhe shpenzimet gjate punës së perditshme siq jane: rregullimi i zyres, akomodimi, vizitat, pritjet në zyre, kontaktet me shoqatat tjera, vizitat tek te burgosurit dhe te familjet e tyre te cilet edhe shume prej tyre nuk qendrojne mire materialisht.
Nga shoqata ne nivel qendror jemi paralajmeruar se asnje ndihme material nuk na i ndajne per shkak te mungeses se mjeteve financiare.
Prandaj jemi te detyruar qe autoritetit tuaj relevant t'ju drejtohemi dhe t'ju kerkojme ndihme ne mbulimin si dhe shpenzimet sado pak te shoqates.
Shoqata ka aktivitete te perditeshme dhe ndihma juaj eshte si garant per funksionimin e shoqates.

Kerkesa per ndihmë konsiston shumat si ne vijim:
Ne shoqatat jemi trajtue nga Komuna njejt me Sumvezone ,qe nga lufta e SHBPK- Vushtrri ka dy vite qe e anashkalojn. Me arsye se koka be gabim.
Ju faleminderit paraprakisht dhe besojme ne mirekuptimin tuaj ne miratimin e kerkeses tone.

Duke pase parasysh qe kjo kategori e atdhetareve shqiptar eshte trajtu ne mnyr me teeger ,ni pjese e te cilve jone torturu edhe deri ne vdekje,ni pjes jone te pa afte, invalid ,me burgje te rane.Shume nga ta me smundje te llojllojshme,shume nga ta jone vdekur po farë benificoni. Kjo kategori e njerzve,me ndoni perjashtim nuk ka pas perkujdesje nga shoqrija dhe istutuconet e Kosovës.
Duke pasë parasysh qështjen e lartpermendur SHBPK shtron këtë,

Kërkesë

Neve pes,Shoqatave qdo her jemi trajtuar njësoj në
Pagesa.Përndryshe është rrezikuar mbarvajtja e punes

Vushtrri
11.05.2023

SHBPK
Tahir Krasniqi

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIKA KOSOVA**

**KOMUNA VUSHTRRI**
**OPŠTINA VUCITRN**

| | |
|---|---|
| **DATË** | **09.06.2023** |
| **PËR/ZA/TO:** | **Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Kuvendin e Komunës** |
| **NGA/OD/FROM:** | **Hava Mlinaku**<br>**Drejtore e Drejtorisë për Administratë** |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | **Informatë për punën e drejtorisë, për periudhën janar-qershor 2023** |

Duke u bazuar në Planin e Punës të Kuvendit për vitin 2023, i cili parasheh që ne si drejtori të paraqesim informatë gjashtëmujore lidhur me punën dhe përgjegjësitë, drejtoria e Administratës bashkëngjit informatat e shërbimeve dhe punët e drejtorisë.

## Informatë për punën e drejtorisë, gjatë periudhës janar-qershor 2023

Informata për punën e Drejtorisë për Administratë përmban aktivitetet dhe detyrat, duke u bazuar në fushat dhe përgjegjësitë që drejtoria ka sipas ligjeve dhe akteve tjera normative.
Drejtoria e Administratës ka vazhduar me punën ekipore në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve të Vushtrrisë dhe më gjerë, e poashtu në përmirësimin e kushteve të punës për të gjithë punëtorët e administratës komunale. Bazuar ne këtë, në përmirësimin e kushteve të punës dhe ofrimin e hapësirave të përshtatshme për punë dhe shërbim sa më të mirë ndaj qytetarëve , vitin e kaluar kemi bërë ndërtimin e sallës në katin e dytë të komunës, dhe këtë vit kemi iniciuar procedurat për furnizim me mikrofon për atë sallë në mënyre që të mbahen takime te ndryshme pune.
Është bërë inicimi i procedurave per fazën e dytë të rregullimit të ngrohjes/ftohjes, është bërë inicimi i procedurës për furnizim dhe montim të tabelës së shpalljes, inicimi i procedurës për furnizim dhe montim të dyerve kryesore të komunës, inicimi i procedurës për servisim dhe mirëmbajtje të aparateve kundër zjarrit dhe gjeneratorit.

Është iniciuar procedura dhe janë pajisur me kartela identifikuese e 25 kryetarët e këshillave lokalë. Procedurat e furnizimit te drejtorisë me material shpenzues zyrtar, furnizimi me certifikata. Zyrtarët e drejtorisë së Administratës në vazhdimësi janë pjesë e komisioneve për vlerësim të aktiviteteve të prokurimit e poashtu në mbikqyrje të kontratave të ndryshme, komisione per pranim dhe të tjera.

Drejtorinë për Administratë e përbëjnë këto njësi:

- Sektori i gjendjes civile;
- Qendra e shërbimeve për qytetarë;
- Zyra për të drejtat e njeriut.
- Sektori për punë të përbashkëta dhe teknologji informative;

Trendi i ngritjes së efikasitetit dhe i ofrimit të shërbimeve më të mira, është në ngritje duke ju falënderuar angazhimit dhe punës rutinore që bëjnë gjithë zyrtarët e drejtorisë.

## Zyra e gjendjes civile

Shërbimi i Gjendjes Civile gjatë periudhës janar-qershor ka ofruar të gjitha shërbimet që janë në kompetencë dhe që kryhen në këtë zyre, trendi i ngritjes së efikasitetit dhe i ofrimit të shërbimeve sa më cilësore dhe më efektive është në ngritje të vazhdueshme në këtë shërbim duke ju falënderuar angazhimit, profesionalizmit dhe punës që bëjnë zyrtarët e gjendjes civile dhe procesit të digjitalizimit të regjistrave dhe dokumenteve të gjendjes civile dhe harmonizimit të procedurave në ofrimin e shërbimeve dhe të lëshimit të certifikatave dhe dokumenteve të gjendjes civile.
Përmes regjistrit qendror elektronik të gjendjes civile është bërë edhe ndërlidhja dhe harmonizimi i të dhënave personale të gjendjes civile për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës me platformën(elektronike) online E-Kosova, dhe që nga data 01 qershor i vitit 2022 është mundësuar

pajisja(nxjerrja) e certifikatave të gjendjes civile nga kjo platformë pa pasur nevojë që të kontaktohen zyrat e gjendjes civile.

Zyra e gjendjes civile është duke e aplikuar edhe sistemin për menaxhimin e radhëve në zyrën e gjendjes civile i cili ka krijuar kushte shumë më të mira për ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe zvogëlimin e parregullsive me rastin e pritjeve dhe marrjes së këtyre shërbimeve, po ashtu është krijuar edhe hapësira për pritje të qytetarëve gjatë marrjes së shërbimit në këtë zyre.

Në vazhdën e ofrimit të shërbimeve më efikase dhe më efektive i kemi thjeshtëzuar procedurat e pagesave për marrjen e certifikatave dhe dokumenteve të gjendjes civile, duke krijuar mundësinë që të gjitha pagesat për këto shërbime të kryhen në sportel te zyrtari i njëjtë i cili e jep shërbimin.

Zyra e Gjendjes Civile ka bashkëpunuar me të gjitha institucionet që kanë interes dhe nevojë për shërbime nga kjo zyrë dhe në vazhdën e këtij bashkëpunimi kemi pasur shumë takime, konferenca dhe trajnime me organizatat vendore dhe ndërkombëtare.
Në vazhdimësi jemi duke bashkëpunuar ngushte edhe me Gjykatat e Kosovës, Agjensionin e sigurimeve pensionale të Kosovës dhe të shteteve të huaja dhe në çdo kërkesë i përgjigjemi në kohe, brenda ditës ose sipas afateve që i cakton gjykata, ngase kërkesat e gjykatës janë gjithmonë me urgjencë dhe si të tilla edhe i trajtojmë.
Poashtu kemi disa marrëveshje obligative që janë të lidhura ndërmjet Agjensionit të Regjistrimit Civil(ARC-së) me Drejtorinë për Kadastër dhe Gjeodezi dhe Drejtorinë për Bujqësi dhe zhvillim Rural dhe në vazhdimësi ju ofrojmë bashkëpunim dhe të dhëna sipas marrëveshjeve të lidhura dhe kërkesave që kanë.
Zyra e gjendjes civile i ka marr te gjitha masat qe te zbatoje vendimin e MAPL-se për shpalljen e muajit prill si muaj për regjistrimin falas të të gjitha fakteve te lindjes për komunitetin RAE, mirëpo ne zyrën e gjendjes civile ne komunën e Vushtrrisë nuk është paraqitur asnjë rast i këtij komuniteti për regjistrim me vonesë dhe falas.

**Në Zyrën e Gjendjes Civile sipas Ligjit Nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile dhe të akteve nënligjore që e rregullojnë fushën e Gjendjes civile kryhen këto shërbime;**

1. Përditësohet regjistri qendror i gjendjes civile,
2. Bëhet regjistrimi i të gjitha fakteve të lindjeve, vdekjeve dhe martesave,
3. Krijohen dhe mbahen aktet e lindjeve, të martesave dhe të vdekjeve,
4. Krijon dhe lëshon numri personal për qytetarët që janë të lindur në komunën e Vushtrrisë,
5. Lëshohen të gjitha certifikatat dhe dokumente të tjera të përcaktuar me ligjin e gjendjes civile dhe UA,
6. Kryhen kurorëzimet e qytetarëve që janë banor të komunës së Vushtrrisë,
7. Bëhet pranimi i kërkesave për natyralizim(Fitim) dhe për lirim të shtetësisë së Kosovës,
8. Bëhet Lajmërimi dhe ç'lajmërimi i vendbanimit,
9. Bëhet përgatitja e raporteve mujore për të gjitha faktet e lindjeve, vdekjeve dhe martesave dhe i dërgohen Entin Statistikor,
10. Regjistrohen dhe evidentohen të gjitha ndryshimet dhe korrigjimet e të dhënave personale për çdo qytetar në regjistrin fizik dhe elektronik,
11. Bëhet skanimi dhe arkivimi i të gjitha dosjeve të zyrës së gjendjes civile,
12. Kryhen edhe shërbime të tjera të gjendjes civile sipas përcaktimeve të bëra në ligjin e gjendjes civile dhe në aktet nënligjore në fuqi.

**Objektivat e zyrës së gjendjes civile kanë qenë:**

1. Ngritja e efikasitetit dhe efektitetit gjatë përditësimit të shënimeve dhe të dhënave personale të qytetarëve në Regjistrin Qendror Elektronik të gjendjes Civile dhe administrimi i regjistrave themeltar fizik.

2. Shqyrtimi i kërkesave në mënyrë të drejtë dhe nxjerrja e vendimeve për korrigjimin, ndërrimin dhe regjistrimin me vonesë të fakteve të lindjes dhe fakteve të vdekjes.

3. Skanimi dhe digjitalizimi i të gjitha dosjeve me rastin e regjistrimit të fakteve të lindurve dhe të të vdekurve në regjistrat themeltar dhe në regjistrin qendror të gjendjes civile, shtypja dhe mbajtja e akteve në mënyrë korrekte dhe cilësore duke krijuar dosje për së cilën rast dhe arkivimi i tyre.

4. Skanimi dhe digjitalizimi i të gjitha dosjeve me rastin e regjistrimit të martesave brenda orarit të punës dhe regjistrimi i martesave jashtë selisë së komunës dhe jashtë orarit të punës, duke i shtypur dhe mbajtur aktet në mënyrë korrekte, cilësore dhe duke krijuar dosje për së cilën rast.

5. Lëshimi i certifikatave dhe dokumenteve të tjera të Gjendjes Civile, si dhe dhënia e shërbimeve të tjera në mënyrë efektive dhe pa gabime.

6. Azhurnimi i të gjitha kërkesave në intranet duke ju dhënë përgjigje dhe zgjidhje në mënyrë efektive dhe pa gabime.

7. Ndërlidhja dhe harmonizimi i të dhënave personale te gjendjes civile për të gjithë qytetarët ndërmjet regjistrit qendror elektronik te gjendjes civile me platformën(elektronike) online E-Kosova me qëllim që të krijohet mundësia e pajisjes(nxjerrjes) së certifikatave të gjendjes civile nga kjo platformë pa pasur nevojë që të kontaktohet zyra e gjendjes civile.

8. Ngritja e përgjegjësisë në ruajtjen e fshehtësisë së të dhënave personale dhe komunikimi i tyre vetëm personave që i parasheh ligji.

Përveç këtyre aktiviteteve dhe detyrave zyrtarët e gjendjes civile kanë qenë të angazhuar edhe në punë të tjera shtesë sipas kërkesës së eprorëve të tyre si; menaxherë të kontratave, komisione për vlerësim, komisione për pranim dhe në komisione të tjera sipas nevojave zyrtare të drejtorisë dhe institucionit.

Gjatë kësaj periudhe janë shqyrtuar të gjitha kërkesat të qytetarëve dhe ju kemi dhenë përgjigje sipas afateve ligjore dhe janë dhënë shërbime efikase dhe efektive.

Më së miri punën e zyrës së gjendjes civile për periudhën janar-dhjetor e pasqyrojnë tabelat e poshtëshënuara, të cila tregojnë në tërësi punën që është bërë nga zyra e gjendjes civile në shërbim të qytetareve duke i proceduar dhe realizuar kërkesat e palëve dhe duke bërë lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve të tjera të gjendjes civile nga zyra e Gjendjes Civile për komunën e Vushtrrisë.

Gjatë kësaj periudhe janë shqyrtuar të gjitha kërkesat e qytetarëve dhe janë nxjerrë këto vendime dhe shkresa të tjera:

| | | |
|---|---|---|
| 1. | Vendime për regjistrime me vonesë të faktit të lindjes | 5 |
| 2. | Vendime për regjistrime me vonesë të faktit të vdekjes | 10 |
| 2. | Vendime për ndërrimin e emrit personal | 6 |
| 3. | Vendime për korrigjime të të dhënave personale në RQ | 15 |
| 4. | Vendime për korrigjimin e të dhënave në regjistra fizik | 39 |
| 5. | Vendime për anulimin e faktit të lindjes | 5 |
| 6. | Dëshmi të vdekjes | 89 |
| 7. | Lajmërime dhe ç'lajmërime të adresës së vendbanimit | 209 |
| 8. | Vendime për korrigjimin e Akteve të lindjes, | 0 |
| 9. | Vendime për korrigjimin e Akteve të vdekjes | 6 |
| 9. | Vendime për korrigjimin e Akteve të martesës | 2 |
| 10. | Aplikime për natyralizim(fitim të shtetësisë) | 5 |
| 11. | Aplikime për humbje të shtetësisë së Kosovës me lirim | 27 |
| 12. | Aplikime për rikthimin e shtetësisë së Kosovës | 4 |
| 13. | Aplikime për fitimin e shtetësisë me martesë | 5 |
| | Gjithsej regjistrime të bëra | **427** |

**Numri i dokumenteve të lëshuara:**

| Nr. | Përshkrimi | Lëshuara |
|---|---|---|
| 1. | Ekstrakt i lindjes | 12055 |
| 2. | Certifikata të lindjes | 6815 |
| 3. | Certifikata të martesës | 3716 |
| 4. | Certifikata të vdekjes | 1201 |
| 5. | Certifikata të Statusit martesor | 380 |
| 6. | Certifikata të shtetësisë | 108 |
| 7. | Certifikata familjare | 4286 |
| 8. | Certifikata të vendbanimit | 2099 |
| 9. | Vërtetim nga arkivi | 269 |
| Gjithsej | | **30929** |

**Regjistrime të bëra në Regjistrat e Gjendjes civile**

| | | |
|---|---|---|
| 1. | Regjistrime të lindjes | 73 |
| 2. | Martesa | 279 |

| | | |
|---|---|---|
| 3. | Regjistrime të vdekjes | 157 |
| 4. | Regjistrime të Shtetësisë | 8 |
| 5. | Regjistrime të lindjes jashtë shtetit | 51 |
| 6. | Regjistrime të martesës jashtë shtetit | 19 |
| 7. | Regjistrime të vdekjes jashtë shtetit | 17 |
| 9. | Shkurorëzime | 45 |
| Gjithsejtë regjistrime të bëra | | **649** |

Ne këtë periudhë janë verifikuar **155** qytetarë në sistemin e ri të gjendjes civile, ndërsa qe nga fillimi i sistemit te ri me **19.02.2013** janë te verifikuar apo te regjistruar ne sistemin e gjendjes civile **101245** qytetar të komunës së Vushtrrisë.

## Sektori për punë të përbashkëta dhe teknologji informative

Sektori për punë të përbashkëta dhe teknologji informative është përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin sistemit të teknologjisë informative të komunës, lektorimi i materialeve të organeve të komunës dhe përkthimi i materialeve zyrtare të komunës nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas si dhe asistimi në përkthimin simulant për nevoja të organeve të komunës, mirëmbajtjen e të gjitha stabilimenteve elektrike dhe teknike në ambientet e objekteve të komunës, ndërrimi dhe riparimi i stabilimenteve, montimin e pjesëve të reja sipas nevojës së parashtruar si dhe të gjitha punët që kanë të bëjnë me logjistikë.

Aktiviteti i Sektorit për punë të përbashkëta dhe teknologji informative ishte i përkushtuar në këto qëllime kryesore:
1. Funksionaliteti i tërë sistemit të teknologjisë informative të administratës së komunës
2. Monitorimi dhe mirëmbajtja e teknologjisë për të siguruar qasje maksimale;
3. Integriteti dhe ruajtja e të dhënave;
4. Mbështetja lidhur me përdorimin dhe shfrytëzimin e resurseve të TI;
5. Menaxhimi dhe administrimi i punëve të përbashkëta

Sektorit për punë të përbashkëta dhe teknologji informative sipas planit vjetor ka pasur 5 objektiva të përcaktuar të përshkruara më lart, ku për arritjen e këtyre objektivave ka zhvilluar 15 aktivitete të tjera të paparapara sipas planit vjetor të veprimit. Të gjitha këto kanë dalë si rezultat i nevojave të Administratës në përmbushjen e obligimeve dhe ngritjes së nivelit të shërbimeve ndaj qytetarëve.

| Përshkrimi i punëve, detyrave dhe intervenimeve të bëra | |
|---|---|
| Formatizime, instalime të aplikacioneve apo softuerëve të ndryshëm apo zgjidhja e problemeve softuerike. | 72 |
| Mbështetje për personel në shfrytëzimin e resurseve të teknologjisë informative. | 46 |
| Zgjidhja e problemeve dhe defekteve të ndryshme. | 41 |
| Postime në ueb-faqe dhe mirëmbajtja e ueb-faqes zyrtare | 13 |
| Lektorimi i dokumenteve të ndryshme për të gjitha organet e komunës, si dhe konsultime për lektorim. | 83 |
| Shërbime përkthimi, përkthimi i dokumenteve apo përkthim simulant sipas nevojës të organeve komunale. | 64 |
| Riparime dhe punë të ndryshme për mirëmbajtje të objektit komunal. | 173 |

**Qendra e shërbimeve të qytetarëve në komunë**

Qendra e shërbimeve të qytetarëve në komunë është përgjegjëse për:

1. Shërbimet e gjendjes civile, tatimit në pronë, regjistrimin e bizneseve, shërbimet kadastrale dhe të gjitha shërbimet e tjera;
2. Përgatitjen dhe vënien në dispozicion të broshurave dhe fletëpalosjeve informative për qytetarët dhe publikimin në ueb-faqe;
3. Këshillimin dhe ndihmën juridike-administrative për mënyrën e plotësimit të kërkesave dhe parashtresave;
4. Pranimin dhe regjistrimin e kërkesave dhe parashtresave;
5. Mbajtjen e dosjeve, statistikave të parashtresave dhe kërkesave të paraqitura nga qytetarët;
6. Shtypjen e librit të protokollit nga sistemi i intranetit;
7. Vëzhgimin e reagimeve të qytetarëve dhe zyrtarëve të komunës ndaj shërbimeve që ofron qendra;
8. Leximin dhe përcjelljen e lëndëve të paraqitura përmes platformës së intranetit;
9. Përcjelljen në mënyrën elektronike të lëndëve tek drejtorët përkatës dhe marrjen e përgjigjes;
10. Protokollimin e dokumenteve të komunës me numër unik të protokollit, përmes sistemit të intranetit.

Zyrtarët e QSHQ-së janë pjesë e komisioneve të ndryshme në vlerësim të aktiviteteve të prokurimit, komision në pranim dhe furnizim si dhe menaxhim te kontratave.

**Gjatë kësaj periudhe Qendra për shërbim me qytetarë ka administruar gjithsej 23.857 kërkesa, për të gjitha organet e komunës dhe drejtoritë, si vijon:**

| Nr. | Përshkrimi | Nr. kërkesave |
|---|---|---|
| 1 | Drejtoria për Administratë | 16.138 |
| 2 | Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër | 3092 |
| 3 | Drejtoria për Buxhet dhe Financa | 1217 |
| 4 | Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural | 262 |
| 5 | Drejtoria për Shërbime Publike | 359 |
| 6 | Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale | 913 |
| 7 | Drejtoria për Arsim | 254 |
| 8 | Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit | 320 |
| 9 | Drejtoria për Inspektime | 220 |
| 10 | Personeli | 651 |
| 11 | Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim | 67 |
| 12 | Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport | 131 |
| 13 | Zyra ligjore | 7 |
| 14 | Kryetari i Komunës | 179 |
| 15 | Drejtoria e Prokurimit | 6 |
| 16 | Kuvendi i Komunës | 33 |
| 17 | Zyra lokale e komuniteteve | 6 |
| 18 | Njësia e auditimit të brendshëm | 2 |
| | | 23.857 |

Në kuadër të QSHQ-së, funksionon edhe qendra e thirrjeve pa pagesë, ku qytetarët mund të kontaktojnë me zyrtarët komunal për problemet të ndryshme, kurse gjatë kësaj periudhe, kjo qendër ka pranuar 89 telefonata, për të cilat qytetarët kanë marrë informata të drejtpërdrejta ose janë udhëzuar për në drejtori tjera.

## Njësiti komunal për të drejtat e njeriut

Ky njësit koordinon, udhëheq dhe mbikëqyr politikat në komunë, në fushën e të drejtave të njeriut, duke përfshirë respektimin e politikave për barazinë gjinore, të drejtat e komuniteteve, përdorimin e gjuhëve, mundësitë e barabarta, zbatimin e politikave për personat me nevoja të veçanta, të drejtat e fëmijëve kundër diskriminimit dhe antitrafikimit.

**Gjatë kësaj periudhe kemi pasur këto aktivitete:**

- Përgatitja dhe dorëzimi i Planit të punës së NJKDNJ tek MAPL dhe ABGJ ;
- Dorëzimi i Raportit një vjeçar të punës të ABGJ – Agjensioni për Barazi Gjinore pranë Zyrës së Kryeministrit;
- Vizitë në terren me zyrtarin për komunitete;
- Pjesëmarrja e rregullt në mbledhjen e KK Vushtrri;
- Pjesëmarrja e rregullt në mbledhjen e KKSB;
- Pjesëmarrja sipas rasteve në mbledhjen e KKRA;
- Plotësimi i pyetësorit nga ABGJ për çështjen gjinore;
- Dërgimi i statistikave në ABGJ lidhur me regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve;
- Dërgimi i të dhënave në ABGJ lidhur Monitorimi i Programit të Kosovës për Barazi Gjinore për periudhën 2022
- Dërgimi i statistikave te Zyra e kryeministrit për qeverisje të mirë, lidhur me Ligjin kundër Diskriminimit;
- Takim në zyre me palët e komunitetit rom;
- Vizitë në 10 shkolla fillore në komunën e Vushtrrisë;
- Organizimi i takimit me gratë kryefamiljare me temë të drejtat e tyre në pronësi;
- Dërgimi i të dhënave për barazi gjinore te koordinatori për performancë;
- Pjesëmarrja në punëtori lidhur me diskriminimin gjinor;
- Pjesëmarrja në punëtori kundër dhunës ndaj gruas;
- Organizimi i Ditës Ndërkombëtare të gruas 8 marsi, marshimi Stop dhunës ndaj gruas;
- ZKK vizitë komunitetit ashkali në Vushtrri;
- Pjesëmarrja në punëtori për Planin Veprues për Mbrojtjen e fëmijës
- Pjesëmarrja 3 ditore në punëtori në Ohër, me temë Gratë, Paqja dhe Siguria
- Pjesëmarrja pesë ditore në punëtorinë lidhur me hartimin e Planit për të kthyerit e komunës sonë;
- Pjesëmarrja në trajnimin "Mbrojtja nga diskriminimi dhe standardet e barazisë";

**Deri në përpilimin e kësaj informate, Drejtoria për Administratë ka realizuar:**

| | |
|---|---|
| Të hyrat nga shërbimet administrative | **30,080.00 €** |

REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E VUSHTRRISË

DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

**05 Nr. 153/2023**
**019.06.2023**

# Raport

(Lidhur me vërshimet e Qershorit 2023)

Gjatë javës së dytë të muajit qershor 2023 gjegjësisht më 14,15, dhe 16 qershor 2023 Komunën e Vushtrrisë e përfshiu një mot me shi të rrufeshëm dhe të dendur, meçe rast një pjesë e territorit të komunës u përfshi nga vërshimet dhe përmbytjet nga ujërat.

Të reshurat e dendura atmosferike të cilat filluan në mbrëmjen e 14 qershorit ishin mjaft të rrufeshëm veçanërisht në pjesën veriore dhe verilindore të Komunës së Vushtrrisë meçë rast *Lumi Tërstena dhe Podranqa dolën nga shtretërit e lumenjve ku për pasojë shumë prona, shtëpi* banimi, anekse shtëpish, prona bujqësore dhe ferma u vërshuan nga uji.

Dëmet më të theksuara janë paraqitë në fshatrat buzë lumit Tërstena i cili për shkake të akumulimit të lartë të ujërave ka dalë nga shtrati i tij dhe ka vërshuar fshatrat Karaqë, Miraqë, Gojbulë ,Begaj si dhe qytetin e Vushtrrisë . Po ashtu rritje të sasisë së ujit nga të reshurat atmosferike janë shënuar edhe në lumin Podranqa, ku për pasojë ky lum ka dalë nga shtrati dhe ka vërshur fshatrat Tërllabuq, Sllatinë dhe qytetin e Vushtrrisë .

Vërshimet përfshinë edhe shumë lokalitete tjera si Bajskën, Dobërllukën, Nadakovcin,Stanovcin, Cecelinë, Samadrexhën, Sllakovcin, Ropicën ,Studimen e Epërme dhe të Poshtme, Shtruherë, Dolak, Akrashticë, Pantinë, Bukosh, Novolan , Prelluzhë, dhe Lokalitete tjera.

Sasia e ujërave është rritur veçanërisht gjatë ditës së premte datë 15.06.2023 ku për pasojë janë përmbytë shumë prona bujqësore dhe ekonomi familjare.

Ekipet e Shpëtimit në koordinim të plotë me Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim janë vu në gjendje gatishmërie dhe kanë punuar në terren për identifikimin e faktorëve , ndihmën, shpëtimin dhe lehtësimin e përballimit të kësaj situate.

Për shkak të vërshimeve është dashtë edhe intervenimi i ekipeve shpëtimtare të përkrahura nga; Njësia e Zjarrfikësve, Policia e Kosovës dhe ekipet vullnetare të cilat janë angazhuar në mbrojtjen dhe shpëtimin e qytetarëve të rrezikuar nga vërshimet.

Sipas parashikimeve preliminare janë vërshuar rreth 130 shtëpi banimi nga të cilat disa familje janë larguar me të parë rrezikun dhe të cilët janë strehuar tek të afërmit e tyre.

Janë evakuuar gjithsej 4 familje me 23 persona.

Viktima në njerëz fatbardhësisht nuk ka pasur.

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim ka angazhuar edhe Kompaninë Kontraktuese e cila ka bërë ndërhyrjet e nevojshme për sanimin e gjendjes dhe minimizimin e pasojave. Është Intervenuar në Fsh. Sllatinë,Karaqë, Gojbulë, Begaj, në qytet përgjat lumit Tërstena dhe Podranqa, në Bajskë, Bukosh, Akrashticë, Shtruherë, Samadrexhë, Nadakovc ,Novolan dhe lokalitete tjera.

Në ndihmë me mekanizëm janë bashkangjitur edhe NN "Hysi Company" dhe NN." Kopshti" si dhe Ndërmarjet Publike "Uniteti" dhe "Përparimi" të cilat kanë intervenuar në hapjen e kanaleve kulluese urave dhe lëshesave si dhe debllokim të rrjedhës së lumenjve si dhe lehtësimin e rikthimit të gjendjes .
Me një angazhim maksimal është arrite që shumica e defekteve dhe pengesave të sanohen.
Intervenimi me makineri është në proces dhe shumë defekte në infrastrukturën rrugore, hapje të kanaleve kulluese, dhe raste tjera të ngjashme janë evituar ose janë në proces.
Në proces e sipër është vendosja e gypave dhe ri funksionalizimi i urave të dëmtuara aty ku ka mundësi teknike dhe kapacitete të mjaftuara të vëllimit të gypave kurse disa Ura siç është ajo në Vushtrri te lagja e Kastratëve ka nevojë të projektohet dhe të rindërtohet tërësisht.
Po ashtu në fsh. Gojbulën është e nevojshme të rindërtohet një urë edhe pse për momentin e kemi riaftësuar por e njëjta nuk ka stabilitet dhe paraqet rrezik për shembje.
Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim në Koordinim të plotë me Kryetarin e Komunës, Shtabin Emergjent (Themeluar sipas Vendimit nr.737/23 të datës 14.06.2023), Policinë e Kosovës, Njësinë e Zjarrfikësve, Shoqatën e Peshkatarëve, Zhytësit dhe qytetar të shumtë kanë ndihmuar në shpëtimin dhe evakuimin e qytetarëve të rrezikuar nga këto vërshime.
Shkolla e Mesme Teknike si dhe Gjimnazi " Eqrem Çabej" janë përgatitë për të pranuar qytetarët e larguar nga shtëpitë e tyre në rast të nevojës për evakuim dhe strehim, por të gjithë të evakuarit kanë gjetë strehim të përkohshëm tek të afërmit e tyre .
Sipas vlerësimit preliminarë të realizuar nga Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim dëmet konsiderohen të jenë relativisht të mëdha.
Pas kalimit të fazës emergjente dhe rënjes së nivelit të ujit , zyrtarët e DMSH-së janë angazhuar në evidentimin dhe vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga kjo fatkeqësi natyrore por në masë të konsideruar edhe fatkeqësi e shkaktuar nga dora e njeriut.
Bazuar në vendimin e kryetarit të komunës nr. 1661/22 të datës 19.12.2022 për formimin e komisionit lidhur me vlerësimin e dëmeve, si dhe Vendimin 739/23 të datës 14.06.2023 për themelimin e një komisioni shtesë për vlerësim të dëmeve nga këto vërshime, komisionet kanë dalë në teren dhe kanë filluar evidentimin dhe vlerësimin në pronat ,tokat bujqësore, infrastrukturën rrugore, lokalet afariste dhe objektet e banimit të cilat janë dëmtuar nga këto vërshime .
Sipas vlerësimit komisionit i cili ende është në proces të vlerësimit të dëmeve si pasojë e vërshimeve janë përmbytë rreth 200 hektar tokë bujqësore prej të cilave rreth 80 hektar të mbjella me grurë dhe kultura tjera vjeshtore dhe 120 hektarë me kultura pranverore
Janë dëmtuar apo kanë pësuar dëme materiale në shtëpi dhe anekse banimi rrethe 130 familje apo biznese kryesisht në qytetin e Vushtrrisë , por edhe në fshatrat Sllatinë , Karaqë, Gojbulë, Begaj, Pestovë, Nadakovc , Stanovc , Shtruherë dhe Dobërllukë.
Janë bllokuar dhe dëmtuar kanale kulluese, lëshesa dhe kanale të ujërave nëntokësorë si dhe ura e lëshesa të kanaleve kulluese përgjatë rrugëve.
Është dëmtuar infrastrukturë rrugore e rendit të katërt si dhe një sipërfaqe e konsideruar e rrugëve të asfaltuara.
Komisionet Komunale për vlerësimin e dëmeve janë në proces të vlerësimit dhe në bazë të vlerësimeve preliminare vlerësohet se dëmet janë tejet të larta .
Komisioni ka grumbulluar të gjitha informatat dhe ka filluar vizitat tek familjet të cilat kanë paraqitë kërkesë për vlerësim . Kërkesa për vlerësim të dëmeve janë duke arrite edhe në ditët në vazhdim dhe do

të shqyrtohen të gjitha kërkesat që arrijnë brenda afatit ligjor sipas Rregullores për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera
Komisioni është në fazën e përllogaritjes dhe vlerësimit përfundimtarë.

Në bazë të dinamikës së punës së Komisioneve pritet që një afat optimal raporti përfundimtar të jetë i gatshëm. I cili raport do ti dorëzohet Asamblesë Komunale për miratim.
Bashkangjitur keni edhe pasqyrimin e dëmeve në formë tabelore:

PASQYRA E DËMEVE NË FORMË TABELARE

| Nr. | Përshkrimi i dëmit | Sasia | Nj.matëse |
|---|---|---|---|
| 1 | Pronat bujqësore të mbjella me grurë dhe bimë tjera vjeshtore | 80 | hektar |
| 2 | Pronat bujqësore të mbjella me kultura pranverore | 120 | hektar |
| 3 | Dëmtimi i rrjetit të kanalizimit dhe lëshesave | 56 | metra |
| 4 | Dëmtimi i Infrastrukturës rrugore asfalt | 800 | $m^2$ |
| 5 | Dëmtimi i rrugëve të rendit të katërt | 15000 | $m^2$ |
| 6 | Dëmtimi i urave ; Karaqë, Gojbulë, Sllatinë, Begaj, | 30 | m |
| 7 | Dëmtimi i urës në Vushtrri | 6 | m |
| 8 | Shembja e dheut dhe dëmtimi i rrugës në Samadrexhë | 100 | $m^2$ |
| 9 | Dëmtimi i argjinaturave të lumit Silnica | 350 | m |
| 10 | Shtëpi banimi orendi dhe pajisje shtëpiake; | 130 | familje |
| 11 | Mbyllje të kanaleve kulluese | 500 | m |

Më 19.06.2023

Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim
Maliq Ferizi